

1 E hënë, 20 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të katër të akuzuarit janë në sallën e gjyqit.

13 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të
14 sotëm, Trupi Gjykses ka disa aspekte për të trajtuar lidhur me
15 kërkesën që ka bërë Prokuroria për dëshmi përmes videolidhjes
16 për Dëshmitarin W02714, përkatësisht kërkesa ka ardhur në
17 parashtrimin e protokolluar F02837.

18 Trupi Gjykses kërkon nga palët, pjesëmarrësit dhe Zyra
19 Administrative që janë parashtrime lidhur me kërkesën për
20 videolidhje nesër në seancë, nesër paradite.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Po mund t'ju themi që tani, që
22 në emër të Ekipit të Mbrojtjes së z. Thaçi, ne nuk kemi asnjë
23 kundërshtim për videolidhje.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne do ta japim
25 përgjigjen nesër siç e shprehët edhe ju.

1 Z. TULLY: [Përkthim] Ne nuk kemi kundërshtime.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ua konfirmojmë nesër siç e
3 kërkuat ju.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Do fillojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
6 W02183.

7 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
10 Dëshmitar. Dëgjoni mirë.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj mirë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e
13 seancës do t'ju japi tekstin e betimit solemn të cilin duhet
14 ta bëni në bazë të rregullës 142 të Rregullores së procedurës.
15 Lexojeni me zë të lartë.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
17 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
18 solemnisht se do ta them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
19 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
20 cilën kam dijeni.

21 DËSHMITARI: HANSJOERG STROHMEYER

22 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 uleni.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
2 sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet se do të
3 zgjasë përreth dy ditë. Sikurse e dini, fillimisht do t'i bëjë
4 pyetjet Prokuroria. Pasi të përfundojnë, Ekipet e Mbrojtjes
5 kanë të drejtën t'ju bëjnë pyetje po dhe Gjykatësit e Trupit
6 Gjykues mund të kenë disa pyetje për ju.

7 Prokuroria parashikon se i nevojiten një orë e gjysmë
8 për t'ju marrë në pyetje. Ndërsa Ekipet e Mbrojtja
9 parashikojnë gjashtë orë. Inkurajoj palët të jenë sa më të
10 kujdesshme në shfrytëzimin e kohës. Trupi Gjykues mund të
11 lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen kushtet përkatëse.

12 Dëshmitar, përgjigju qartë me fjali të shkurtra. Në qoftë
13 se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që pyetja të
14 përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta
15 sqarojmë.

16 Gjithashtu mos harroni të na thoni ku i bazoni ju faktet,
17 rrethanat për të cilën do t'ju bëjnë pyetje.

18 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të flisni për
19 korrigjimet që iu keni bërë deklaratave tuaja të mëparshme, ju
20 rikujtoj se duhet të thoni me zë të lartë për procesverbal që
21 deklaratat me shkrim, bashkë me korrigjimet përkatëse,
22 pasqyrojnë saktësisht dëshminë tuaj.

23 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
24 se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

25 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk

1 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
2 jashtë ambienteve të Gjykatës. Në qoftë se dikush jashtë
3 Gjykatës ju bën pyetje për dëshminë tuaj, na informoni
4 menjëherë.

5 Ju lutem ndërprisni fjalën nëse u kërkoj unë, si dhe
6 ndërprisni fjalën nëse më shihni që unë po ngre dorën. Kjo do
7 të thotë se unë duhet të jap një udhëzim.

8 Në çdo moment që keni nevojë për një pushim, na informoni
9 dhe ne do të bëjmë organizimin përkatës.

10 Fillojmë tani me pyetjet e Prokurorisë, të cilët janë
11 ulur në të majtën tuaj. Dëgjojini me vëmendje.

12 Vazhdoni.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
14 Dhe mirëmëngjes.

15 Pyetje nga znj. Iodice:

16 PY. Mirëmëngjes, z. Strohmeyer. Unë quhem Vega Iodice dhe unë
17 do t'ju bëj pyetje në emër të Prokurorisë. Sikurse ua
18 shpjegova në takimin e fundit që patëm bashkë, unë nuk do t'ju
19 bëj pyetje për çdo aspekt të mundshëm që juve mund të keni
20 dijeni, ekziston dhe mundësia të pranohen deklaratat që keni
21 dhënë më herët ku gjendet ky informacion. Për të bërë këtë
22 duhen ndjekur disa hapa proceduralë.

23 Përpara se të fillojmë me këto hapa proceduralë, duhet të
24 flasim për identitetin tuaj.

25 Ju lutem thoni emrin dhe mbiemrin.

1 PË. Hansjoerg Strohmeier.

2 PY. Datëlindja jua?

3 PË. 5 shkurt 1962.

4 PY. Çfarë shtetësie keni?

5 PË. Gjerman.

6 PY. Çfarë profesioni keni?

7 PË. Aktualisht, punoj në Kombet e Bashkuara.

8 PY. Faleminderit. Dëshmitar, ju i keni dhënë deklarata ZPS-së
9 në të shkuarën dhe jua dhamë mundësinë që t'i rishikonit dhe
10 një herë kur u përgatitët për këtë dëshmi. Ne do kërkojmë që
11 kjo deklaratë të pranohet si provë gjyqësore.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran
13 materiali që mban numrin ERN 101610-101634 RED dhe përkthimi
14 në gjuhën shqipe dhe kjo nuk duhet transmetuar për publikun.

15 PY. A ju kujtohet që i keni dhënë një deklaratë ZPS-së në
16 2021 të cilën e keni nënshkruar?

17 PË. Po.

18 PY. A ju kujtohet që e rilexuat javën e kaluar?

19 PË. Po.

20 PY. A ju kujtohet që ju patët mundësinë të bënit disa
21 korrigjime dhe disa sqarime në këtë deklaratë?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujtohet që korrigjimet u hodhën më pas në një
24 shënim të cilin ju e lexuat dhe një herë në fund?

25 PË. Po.

1 PY. A konfirmoni që përmbajtja e atij shënimi pasqyronte
2 saktësisht dhe tërësisht ndryshimet që bëtë ju?

3 PË. Po.

4 PY. Duke marrë tani parasysh korrigjimet dhe sqarimet që bëtë
5 ju javën e kaluar, përmbajtja e dëshmisë suaj, e deklaratës
6 suaj a është e saktë dhe e vërtetë me aq sa besoni dhe keni
7 dijeni?

8 PË. Po.

9 PY. Në qoftë se do t'ju bënin të njëjtat pyetje sot për të
10 njëjtat ngjarje përgjigjet tuaja a do të ishin të njëjtat?

11 PË. Po.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi kemi
13 përmbushur kriteret e rregullës 154 në përputhje me vendimin
14 F2720, paragrafi 69, kërkoj pranimin e deklaratës që mban
15 numrin 101610-101634 RED si provë gjyqësore dhe klasifikimi
16 duhet të jetë konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime me
20 përjashtim të kundërshtimeve që kemi bërë për provat materiale
21 shoqëruese dhe për të cilin ju keni marrë vendim. Sidoqoftë sa
22 i takon klasifikimit, nuk e kuptoj çfarë arsye ka, përndryshe
23 Prokurorisë do t'i kërkonim që të përgatisë një dokument, një
24 version të redaktuar publik.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

1 kundërshtime të tjera?

2 Z. DIXON: [Përkthim]. Kundërshtim jo.

3 Z. TULLY: [Përkthim] Jo.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, përveç kundërshtimeve që kemi
5 bërë në të shkuarën.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Disa nga dokumentet kanë disa
7 përmbajtje të kufizuara, por nuk ka problem do të përgatisim
8 një version të redaktuar publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
10 Dokumenti 101610-101634 RED dhe përkthimi në gjuhën
11 shqipe pranohet.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
13 numrin P01968, me klasifikim konfidencial.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkojmë dhe pranimin e Shënimit
15 Përgatitor numër 1 që mban numrin ERN 124639 dhe 124647, po
16 ashtu konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime për shënimin përgatitor?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime, po edhe një
20 herë do të donim që të kishte një version të redaktuar publik
21 edhe për shënimin përgatitor.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
24 kundërshtime nga palët e tjera, atëherë Shënimin Përgatitor
25 numër 1 me ERN 124639-124647 pranohet.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e
2 provës P01969 dhe klasifikimi është konfidencial.
3 Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull. Kam dhe 11 prova
6 materiale shoqëruese. Unë do t'i lexoj një për një për
7 procesverbal.

8 Dokumentit i parë --

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I doni me një
10 numër të vetëm apo doni t'u jepni numra veçmas gjithsecilës?

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Secila të ketë numrin e vet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë dokumenti i parë është
14 101960 deri në 101963 dhe mund të jetë publik.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, kundërshtim të reja.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
19 numër 101960-101963 pranohet.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
21 numrin e provës P01970 dhe klasifikimi është publik.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i dytë mban numrin
23 203165-203171 dhe po ashtu mund të jetë publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime të reja.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shoh që nuk
3 ka kundërshtime të tjera. Këtë kundërshtimin e keni të
4 vazhdueshëm për të gjitha provat?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, për të gjitha provat kam të
6 njëjtin kundërshtim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Do ta marrim parasysh këtë gjë.

9 Dokumenti SPOE00203165-203171 pranohet.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
11 numrin P09171 dhe është publik.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës është
13 dokumenti me numrin 012642-012643 dhe është konfidencial.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
15 [Përkthim] S'ka kundërshtime?

16 Atëherë dokumenti 102642 deri në numër 102643 pranohet.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
18 numrin P01972 dhe klasifikimi është konfidencial.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo. Një korrigjim. Se unë lexova
20 gabimisht numrin e ERN. Bëhet fjalë për materialin që ka
21 numrin 102642-012643.

22 Dokumenti i radhës mban numrin SPOE00209742 deri në
23 00209755 dhe mund të jetë publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
25 [Përkthim] Nuk ka kundërshtime. Atëherë dokumenti me

1 numër 00209742 deri në 00209755 pranohet.

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti mban numrin
3 P01973 dhe klasifikimi është publik.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti mban numrin
5 P01973 dhe klasifikimi është publik.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës SPOE00203174
7 deri në 00203187 dhe mund të jetë publik.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
9 është i njëjti? Në qoftë se nuk ka kundërshtime të reja,
10 atëherë materiali në fjalë pranohet, përkatësisht materiali
11 0020317-00203187 pranohet.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
13 numrin e provës P01974 dhe klasifikimi do të jetë publik.
14 Faleminderit.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës është
16 SPOE00246083-00246087. Ky dokument duhet të jetë konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me
18 përjashtim të kundërshtimit që qëndron, nuk ka kundërshtime të
19 tjera, atëherë dokumenti me numër 00246083-00246087 pranohet.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
21 numrin e provës P01975 dhe klasifikimi është konfidencial.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës SPOE00203088
23 deri në 0030903 dhe është - më falni - 00203093 dhe është
24 konfidencial.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me përjashtim

1 të kundërshtimit të shprehur më herët, nuk ka kundërshtime të
2 reja. Dokumenti 00203088-00203093 pranohet.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
4 numrin e provës P01976 dhe klasifikimi është konfidencial.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës SPOE00246100
6 deri 246102 dhe mund të jetë publik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me përjashtim
8 të kundërshtimit të shprehur më herët, nuk ka kundërshtime të
9 tjera, dokumenti SPOE00246100-246102 pranohet.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
11 provës P01977 dhe klasifikimi është publik. Faleminderit.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës SITF00173049
13 deri në 173052 dhe klasifikimi është konfidencial.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me përjashtim
15 të kundërshtimit të shprehur më herët, nuk ka kundërshtime të
16 tjera, dokumenti SITF001723049 deri në 00173052 pranohet.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
18 numrin e provës P01978 dhe klasifikimi konfidencial.
19 Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i radhës është
21 SITF00172727 deri në 172735 dhe mund të jetë dokument publik.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me përjashtim
23 të kundërshtimit të shprehur më herët, nuk ka kundërshtime të
24 reja, dokumenti SITF00172727 deri në 00172735 pranohet.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 12

1 do të marrë numrin P01979 dhe klasifikimi publik.

2 Faleminderit.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti i fundit SPOE00246107
4 deri në 246112 dhe klasifikimi konfidencial.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me përjashtim
6 të kundërshtimit të shprehur më herët, nuk ka kundërshtime të
7 tjera dhe dokumenti me numër SPOE00246107 deri në 246112
8 pranohet.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
10 numrin e provës P01980 dhe klasifikimin e ka konfidencial. Ju
11 faleminderit.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen
13 tuaj do të doja të lexoja një përmbledhje të shkurtër publike
14 për këtë dëshmitar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari W02183 ka qenë
17 këshilltar juridik në Misionin e Kombeve të Bashkuara në
18 Kosovë nga qershori deri në shtator të 1999. Dëshmitari W02183
19 do të japë dëshmi për situatën që ka parë në Kosovë kur ka
20 mbërritur dhe takimet që ka pasur ai me udhëheqësit e UÇK-së
21 dhe çështjet që kanë diskutuar së bashku.

22 Dëshmitari do të japë dëshmi për njësitë policore të UÇK-
23 së, autoritetet lokale dhe tensionet që kanë pasur UNMIK-u me
24 Qeverinë Provizore të Kosovës.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Sapo më thanë që

1 dokumenti që keni pranuar me numrin P1978 ka dy përkthime në
2 gjuhën angleze, nuk u lexua. Ma merr mendja që janë pranuar të
3 dyja përkthimet, por sidoqoftë për procesverbal duhej thënë,
4 që anglishtja ka dy numra të ndryshëm ERN.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu është?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do ta verifikoj dhe do t'ju them.
7 Dhe do t'ju jap ERN e saktë për anglishten.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të vazhdoja me disa
10 pyetje shtesë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
12 vazhdoni.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, në deklaratën tuaj në paragrafin 49 dhe 58 ju
15 keni përmendur --

16 PË. Ju lutem, vendosini në ekran.

17 PY. Patjetër.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të vendosim faqen 13 në PDF,
19 paragrafi 49.

20 PY. Ju keni thënë që keni pasur dy probleme, dy vështirësi:
21 një, të ushtrohej autoriteti i UNMIK-ut në zonat që
22 kontrollonte UÇK-ja, administrata dhe policimi dhe përpjekja e
23 dytë, ishte krijimi i -- ishte rendi publik edhe ofrimi i
24 shërbimeve jetike.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të doja që përbri të vendosej

1 materiali që mban numrin SITF0011411 deri në 11413.

2 PY. Dëshmitar, ky është një raport i OSBE-së që mban datën 18
3 qershor.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në faqen
5 tjetër.

6 PY. Periudha që mbulon ky raport është data 15, 16 qershor
7 1999.

8 Së pari, a kanë qenë këto llojet e raporteve që merrnit
9 ju dhe që diskutonit me kolegët në momentin që i merrnit
10 raporte të tilla?

11 PË. Po. Këto lloj raportesh merrnim, po.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim pak më lart në krye të
13 faqes

14 PY. Ju lutem fillimisht, a ju kujtohet nëse UNMIK-u i merrte
15 raporte të tilla dhe në ç'formë i merrnit, domethënë, a i
16 merrnit me gojë, ai merrnit me shkrim raporte të tilla?

17 PË. Nuk më kujtohet konkretisht si e kemi marrë raportin në
18 fjalë, por më kujtohet që, njësoj si në shumë misione të
19 Kombeve të Bashkuara, kishim një sistem për marrjen e
20 raporteve. Pra, për informacionet që nuk ishin të klasifikuara
21 shkonin në një sistem, kishte një sistem shpërndarjeje dhe
22 këshilltar juridik sigurisht duhej të merrej patjetër një
23 raport i tillë.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Fokusohemi tek teksti ku është

1 poshtë titullit "Situata e përgjithshme".

2 PY. Dy paragrafët e parë, dy paragrafët e parë flasin për
3 faktin që UÇK-ja kishte marrë gjykatën dhe stacionin policor
4 në Prizren edhe ndërtesën PTT në Ferizaj. A ju kujtohet të
5 keni marrë një raportim të tillë, pra, përkatësisht që UÇK-ja
6 kishte marrë në kontroll këto ndërtesa?

7 PË. Po, më kujtohet. Po do të doja të shtoja diçka, se më
8 kujtohet diçka konkretisht nga Prizreni. Një nga stafi ynë
9 atje, Mark e kishte emrin, Mark Baskin, shkoi shumë herët në
10 Prizren që të ishte si administrator rajonal atje,
11 përfaqësues. Edhe situata në Prizren, sipas Markut, ka qenë
12 shumë e tensionuar, shumë kaotike dhe duhej patjetër që të
13 kishim një përfaqësues të stafit tonë në Prizren, vetëm në
14 Prizren. Ndërsa në vendet e tjera, na u desh më shumë kohë të
15 vendosnim praninë tonë.

16 Dhe kemi dëgjuar informacionet dhe kemi marrë raportime
17 përmes Markut çdo ditë madje ndonjëherë çdo disa orë, ai na
18 raportonte për situatën e Prizrenit.

19 PY. Faleminderit. A është ky një nga shembujt e raportimeve
20 që merrnit ju për mënyrën se si UÇK-ja ushtronte kontroll apo
21 kishte marrë në kontroll qeverinë dhe administratën?

22 PË. Po.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim më poshtë paragrafin 50.
24 Faleminderit.

25 PY. Në këtë paragraf, ju keni thënë se si filluat të merrnit

1 informacionet për vrasje, zhdukje dhe krime të tjera.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë ju lutem në faqen tjetër
3 të raportit të OSBE-së.

4 PY. Këtu te paragrafi i tretë thuhet se shefi i Kryqit të Kuq
5 në Ferizaj i ka raportuar OSBE-së se UÇK-ja kishte kryer disa
6 rrëmbime. A janë këto raportet që merrnit ju asokohe lidhur me
7 këto problematika?

8 PË. Po. Në këtë periudhë kohore pak a shumë kemi dëgjuar për
9 rrëmbime të pretenduara, po dhe në fakt, që kanë ndodhur
10 konkretisht.

11 PY. Faleminderit.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj
13 pranimin e këtij dokumenti si provë gjyqësore.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
15 kundërshtime?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

18 Z. TULLY: [Përkthim] S'ka kundërshtime.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Dokumenti me numër SITF0011411 deri në 0011413 pranohet.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
22 numrin e provës P01981. Dhe klasifikimi është konfidencial.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

25 Riklasifikoheni si publik.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vendosim në ekran materialin që
3 mban numrin SITF00011414 deri në 11416. Faleminderit.

4 PY. Ky është një tjetër raport i OSBE-së.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
6 kalojmë tek faqja tjetër. Periudha që mbulohet nga ky raport
7 është data 16 deri në 17 qershor 1999. Të kalojmë tek faqja që
8 përfundon me 1415, që është faqja tjetër. Ju kërkoj ndjesë,
9 kalojmë një faqe më përpara dhe pastaj tek faqja e fundit.
10 Faleminderit.

11 PY. Paragrafi i fundit i këtij raporti përmend që civilë
12 serbë janë takuar me anëtarët e OSBE-së dhe kanë kërkuar
13 ndihmë sa i takon kidnapimeve të pretenduara të anëtarëve të
14 familjes së tyre nga UÇK-ja. Dhe gjithashtu edhe kanë
15 raportuar lidhur me dy ndërtesat të cilat janë okupuar nga
16 UÇK-ja.

17 Dëshmitar, a është ky një tjetër shembull i llojeve të
18 raporteve që ju keni parë dhe që janë shkruar sa i takon
19 kidnapimeve dhe sa i takon ndërtesave të zaptuara prej UÇK-së?
20 PË. Nuk kam qenë i pranishëm vetë në asnjërin prej këtyre
21 rasteve, po këto thuhën në raporte.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
23 dokument të pranohet në prova gjyqësore.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtim?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
3 ka kundërshtim, dokumenti SITF00011414 deri në 11416 pranohet
4 në prova gjyqësore.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
6 t'i caktohet numri i provës P01982. Dhe aktualisht është i
7 klasifikuar si konfidencial.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
10 riklasifikoheni.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Patjetër.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoj që tani të paraqitet në
13 ekran dokumenti SPOE0061169 deri në 61173. Po ashtu është
14 dokument publik edhe ky.

15 PY. Dëshmitar, ky është një tjetër raport i OSBE-së që mban
16 datën 23 korrik 1999.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër e
18 raportit për Sekretarinë. Periudha e raportimit është nga 15
19 korriku deri më 21 korrik 1999. Të kalojmë tek faqja tjetër,
20 paragrafi i katërt. Faleminderit.

21 PY. Nëse e lexoni këtë paragraf, Dëshmitar, këtu thuhet që
22 është marrë administrata civileve e qytezave dhe fshatrave nga
23 UÇK-ja dhe po ashtu thuhet që ekziston frika që UÇK-ja të
24 mbajë këtë pozicion monopol në komuna. Thuhet po ashtu që kjo
25 nuk është në përputhje me rolin administrativ të UNMIK-ut

1 sikurse parashikohet nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të
2 Kombeve të Bashkuara 1244.

3 A është kjo në përputhje me atë çfarë keni parë ju vetë
4 me sytë tuaj gjatë asaj periudhe, Dëshmitar?

5 PË. Po. Nuk di t'ju them në qoftë se e kam parë me sytë e mi
6 ose në qoftë se e kam dëgjuar, por këto janë problematikat të
7 cilat ne i kemi diskutuar. Disa prej nesh ndonjëherë i kanë
8 parë vetë, disa prej nesh i kanë dëgjuar nga të tjerët.

9 Megjithatë gjatë ditëve të para ose javëve të para të
10 vendosjes tonë, sikurse e shpjegova edhe më herët, të nderuar
11 Gjykatës, në fillesa ishte e vështirë për ne për të ushtruar
12 mandatin tonë edhe ne kishim frikë që në fakt nuk do ta
13 ushtronim dot funksionin tonë dhe kishim përshtypjen që për
14 shkak të zhvillimeve mbase nuk do ta kishim të mundur që të
15 krijonim një administratë civile në Kosovë.

16 PË. Në rregull.

17 PY. Nuk e di, nëse më lejoni që të shtoj dhe diçka tjetër.

18 Një konstatim të vogël. Nëse do i kthehem paragrafit 49 të
19 deklaratës time që ma treguat pak më herët, ku thashë që këto
20 ishin dy detyrat tona kryesore. Në qoftë se e lexoni atë
21 paragraf, unë e përshkruaj një prej detyrave si një detyrë që
22 na ishte caktuar neve, domethënë, për rendin dhe sundimin e
23 ligjit, megjithatë kjo çështje mori dimensione kaq shumë të
24 mëdhaja sa ne e kemi identifikuar atë si detyrë më vete.

25 Domethënë, nuk është se ishte një prej detyrave të mandatuara

1 për ne, por ishte një prej detyrave kryesore, një prej
2 aspekteve kaq shumë të mëdhaja tonat sa që ne e përcaktuam atë
3 si një shtyllë kryesore dhe për këtë arsye për ne ishte e
4 rëndësishme që të përcaktonim mënyrën se si do ta garantonim
5 atë duke i parë në kontekstin e realitetit që ishte në terren.

6 Kështu që sa i takon këtij paragrafi, mund të them që nuk
7 kam parë gjë, nuk ka konstatuar me sy vetë gjë, megjithatë çdo
8 zyrë e UNMIK-ut ose e OSBE-së në terren në këtë kohë këto janë
9 lloje problematikash ose çështje të cilat janë diskutuar apo
10 të cilat janë dëgjuar.

11 PY. Në rregull.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të kalojmë tek faqja tjetër,
13 tek pjesa që fletë për "Të drejtat e Njeriut".

14 PY. Në paragrafin e parë të kësaj faqeje flitet për
15 përshkallëzimin e tensioneve pas gjetjes së trupave të vdekur
16 të disa serbëve që pretendohet që të jenë gjetur në Gjakovë,
17 në Ramoc edhe Gjakovë. Ndërkohë që më pas flitet për lëvizjet
18 e pakicave që janë kufizuar si rezultat i rrëmbimeve nga UÇK-
19 ja si dhe pretendimeve të pranisë së qendrave të ndalimit në
20 Junik edhe Ponoshic.

21 A është kjo një tjetër, a është ky një tjetër shembull i
22 raporteve të krimeve të kryera nga UÇK-ja po ashtu dhe i
23 qendrave të ndalimit të UÇK-së që keni dëgjuar gjatë kohës kur
24 keni shërbyer në Kosovë, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Gjatë kohës kur keni qenë në Kosovë a e keni vizituar
2 ndonjëherë Pejën?

3 PË. Po, kam qenë mbase një ose dy herë. Nuk ua them
4 ekzaktësisht, nuk i mbaj mend datat ekzaktësisht. Megjithatë
5 mesa më kujtohet kam shkuar pak kohë pasi kanë ardhur
6 administratorët e distrikteve siç quheshin asokohe.

7 PY. A ju kujtohet se me ç'rast ose cila ka qenë arsyeja pse
8 keni shkuar në Pejë, kur keni vizituar Pejën një ose dy herë
9 siç thatë?

10 PË. Në njërën prej herëve kemi shkuar për të diskutuar këto
11 çështje konkrete. Dhe sikurse e kam thënë dhe një pjesë të
12 deklaratës time, një mënyrë për të matur procesin dhe për të
13 qenë i dukshëm ose vizibël apo për t'u siguruar që UNMIK-u
14 ishte i pranishëm dhe gjithashtu edhe për të dhënë dhe
15 kontributin e vet për sigurinë dhe për rendin, ishte që të
16 caktohej shumë shpjet një trupë, një grup mobil dhe një trupë
17 gjykatësish për raste për të nxjerrë dekrete për raste
18 emergjencash.

19 Dhe nuk mund t'ju them ekzaktësisht se bëhet fjalë për
20 këto raste të cilat janë përshkruar këtu në raport, nuk e di
21 në qoftë se kanë qenë këto rastet që kanë bërë të mundur
22 shkuarjen time në Pejë. Por unë vetë nuk është se kam qenë
23 pjesë e paneleve, se nuk është se ka qenë detyra ime që të
24 shërbeja si gjykatës i përkohshëm ose pjesë e paneleve të
25 tilla për të bërë vlerësimet për situatën. Por jam i sigurtë

1 që këto gjykatësit kanë shkuar dikur eventualisht në terren.

2 PY. Për ta sqaruar, ju thoni që keni vendosur ose keni
3 stacionuar, keni dërguar trupa gjykuese gjykatësish për të
4 trajtuar situata të tilla, këtë po thoni?

5 PË. Po. Kemi krijuar një trupë gjykuese të gjykatësve që
6 pasqyronin, sipas mendimit tonë, konfigurimin e Kosovës plus
7 edhe ekspertë ndërkombëtarë për të bërë vlerësimin e
8 situatave. Nëse nuk gabohem bëhej fjalë për një trupë gjykues
9 prej shtatë vetësh, jo pesë vetësh. Kështu që ekzistonte një
10 grup i tillë që ishte krijuar në Prishtinë, por që sigurisht
11 që grupi shkonte dhe në vende të tjera sipas nevojës si, për
12 shembull, në Prizren apo në Pejë në qoftë se do ishte e
13 nevojshme, pra, nëse do kishte zhvillime të tilla ose në qoftë
14 se do merrnim raporte të kësaj natyre që sapo pamë, atëherë ky
15 grupi do zhvendosej apo do shkonte në vendin ku kishte ndodhur
16 situata ose për ku kishte ardhur raportimi.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e këtij
18 dokumenti.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtim?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
23 ka kundërshtim, dokumenti SPOE00061969 deri në 61973 pranohet
24 në provë gjyqësore.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Është

1 dokument i cili do marrë numrin e provës P01983 dhe është i
2 klasifikuar si publik. Faleminderit.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është në rregull klasifikimi si
4 publik?

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Faleminderit, i nderuar
6 Gjykatës.

7 Ju lutem paraqisni dhe një herë në ekran deklaratën e
8 dëshmitarit, ka numrin e provës P1968, të shohim dokumentin në
9 faqen 10 të PDF-së.

10 PY. Shohim paragrafin 34. Në këtë paragraf thuhet që juve u
11 informuat sa i takon njësive të parregullta policore prej UÇK-
12 së edhe funksioneve policore të ekzekutuara po ashtu nga UÇK-
13 ja.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ndërkohë në qoftë se do të
15 kalojmë tek faqja tjetër e deklaratës në paragrafin 42.

16 PY. Këtu thuhet që ju keni thënë që këto njësi të UÇK-së nuk
17 kishin shenja dalluese të forcave policore të rregullta.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tek gjysma e parë e ekranit do i
19 kërkoja Sekretarit që të paraqesë në ekran dokumentin me numër
20 ERN 1012757 deri në 012766.

21 PY. Është një dokument kabllor, është një fishë, informacion
22 i dhënë nga Kombet e Bashkuara për administratën.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do shohim faqen 5 të këtij
24 dokumenti.

25 PY. Në këtë kabllogram, në shtojcën A thuhet që ka pasur

1 incidente të raportuara në situatën policore të UNMIK-ut.

2 Atëherë le të shikojmë shënimet që kanë të bëjnë me datën 21
3 dhe 23 korrik 1999.

4 Në shënimet në këto dy data thuhet që KFOR-i ka
5 kontrolluar në ambientet e UÇK-së, ka shpëtuar të ndaluar dhe
6 po ashtu raportohet që UÇK-ja ka kidnapuar shqiptarë. Ndërkohë
7 që më datë 23 korrik raportohet një person i cili është vrarë
8 nga anëtarë të UÇK-së.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nëse kalojmë pak më poshtë dhe
10 shikojmë shënimet që janë hedhur për sa i takon datën 24 dhe
11 25 korrik 1999.

12 PY. Këtu përfshihen raporte të ngjashme që kanë të bëjnë me
13 burgje të cilat drejtoheshin nga UÇK-ja si dhe rrahjet dhe
14 keqtrajtimet nga policia ushtarake e UÇK-së, pra, një person i
15 cili është rrahur nga UÇK-ja dhe gjithashtu edhe raporte të
16 cilat kishin të bënin me keqtrajtimin e policisë ushtarake të
17 UÇK-së.

18 Në qoftë se mundët që ta lexonit mund të kalojmë tek
19 faqja tjetër, përndryshe do ju kërkoja që t'i hidhnit një sy.
20 PË. Mund të kalojmë tek faqja tjetër.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë shikojmë gjithashtu edhe
22 shënimet për datën 5 dhe 6 gusht 1999. Faleminderit.

23 PY. Të gjitha këto shënime thonë që ka pasur raporte për sa i
24 takon kidnapimeve dhe rrahjeve nga anëtarë ose ushtarë të UÇK-
25 së.

1 PË. [Nuk ka përkthim].

2 PY. A janë këto llojet e raporteve që keni marrë ju në atë
3 kohë sa i takon krimeve që pretendohet që të ishin kryer nga
4 pjesëtar të UÇK-së edhe pjesëtarë të policisë ushtarake të
5 UÇK-së?

6 PË. Po. Edhe një herë dhe në këtë rast nuk është se më
7 kujtohet ndonjë rast konkret, megjithatë këto ishin llojet e
8 raporteve

9 PY. Faleminderit.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
11 dokument të pranohet në provë gjyqësore.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendova që ky
13 dokument është pranuar në provë.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Duhet ta
15 kontrolloj dhe një herë do shoh në qoftë se është pranuar apo
16 jo.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kam numër
18 ERN për këtë dokument.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk është pranuar. Më thonë
20 kolegët që nuk është pranuar. Numri i ERN është 012757 deri në
21 012766.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
23 kundërshtim?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të them që

1 dëshmitari nuk është se dha asnjë hollësi sa i takon
2 informacionit. Plus që është një dokument i cili përbëhet prej
3 dhjetë faqesh dhe që përfshin dhe përshkruan disa ngjarje.

4 Nuk është se po e kundërshtoj, po thjesht po them që
5 dëshmitari nuk është se tha shumë lidhur me këto raporte dhe
6 mendoj që pesha që i duhet dhënë këtij dokumenti duhet të jetë
7 minimale.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në thelb
9 dëshmitari po thotë që ky është lloji i raporteve që zakonisht
10 ata merrnin, domethënë, kjo është natyra e dëshmisë që po jep
11 dëshmitari. Megjithatë e kuptoj, e mirëkuptoj komentin që ju
12 bëtë.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës edhe në këtë
14 rast këto janë lloj raportesh që dëshmitari nuk është se i
15 kujtohet. Se unë personalisht e kundërshtoj pranimin e këtij
16 dokumenti në provë gjyqësore sepse dhe këtu citoj dëshmitari
17 thotë që "nuk i kujtohet specifikisht ndonjë prej rasteve që
18 jepet apo përshkruhet në këtë dokument".

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
20 do e pranojë dokumentin, megjithatë do t'i japë peshën
21 relevante në varësi të asaj çfarë tha dëshmitari lidhur me të.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
23 Gjykatës. Dokumenti do të marrë numrin e provës P01984.
24 Aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si publik.

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 27

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
2 riklasifikoheni.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për pjesën e
4 mbetur të pyetjeve kërkoj që të kalojmë në seancë private
5 sepse dokumentet i nënshtrohen kufizimeve sipas rregullës 107.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
7 në seancë private atëherë.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi në seancë publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Do bëjmë pushim për dhjetë minuta.

13 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

14 --- Seanca rifillon në orën 10.11

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
16 dëshmitarin në sallë ju lutem, znj. Sekretare.

17 Kalojmë në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 37

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeyer (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 49

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 50

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

2 Po, desha t'ju njoftoja që materialet janë ngarkuar në
3 listën tonë të materialeve.

4 PY. Po filloj dhe një herë me që jemi në seancë publike. Z.
5 Strohmeier, unë quhem Luka Misetic. Jam avokati mbrojtës i z.
6 Thaçi dhe do t'ju bëj disa pyetje.

7 Pyetja ime e parë është kjo: A keni komunikuar me ndokënd
8 kohët e fundit, me përjashtim të ZPS-së, për dëshminë tuaj në
9 mënyrë që të rifreskonit kujtesën?

10 PË. Jo.

11 PY. Në paragrafin 23 të Shënimit Përgatitor numër 2, ju keni
12 thënë që kohët e fundit keni gjetur disa blloqe shënimesh për
13 kohën tuaj në Kosovë, por nuk i lexuat se nuk menduat që ishin
14 të nevojshëm, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Nga i gjetët, si i gjetët këto blloqe?

17 PË. Ne transferuam disa plaçka nga shtëpia ime dhe gjatë
18 transferimit të sendeve gjeta dhe kuti nga bodrumi dhe blloqet
19 i gjeta në bodrum. Hapa kutinë pashë që ishin disa shënime. I
20 mora të gjitha blloqet e shënimeve, që kam qenë në të gjitha
21 misionet e mia dhe në këto kuti gjeta disa blloqe shënimesh që
22 ishin në kohë për periudhën në Kosovë.

23 PY. Po nuk i lexuat?

24 PË. Jo.

25 PY. Të fillojmë nga periudha juaj e hershme me UNMIK-un, ju

1 keni thënë në intervistën me ZPS-së që po lexonit për misionin
2 e Kombeve të Bashkuara dhe mandatin në Kosovë gjatë kohës që
3 po fluturonit drejt Kosovës më 10 qershor 1999, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ju thatë që dhe ju dhe z. De Mello, që ka qenë
6 Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarisë së Përgjithshme në
7 Kosovë, e kishit për detyrë të studionit rolin dhe autoritetet
8 dhe kushtet që do të kishte Rezoluta 1244 e Këshillit të
9 Sigurisë dhe të gjenit si do zbatohet kjo në praktikë?

10 PË. Po.

11 PY. Çfarë ka qenë kaq e paqartë për Rezolutën 1244?

12 PË. Fillimisht z. De Mello, kështu funksiononte, këtë e ka
13 bërë edhe më vonë në mandate të tjera, bënte ndryshime, bënte
14 disa shënime me ngjyra në dokumentet përkatëse që të kuptohej
15 çdo gjë. Ne kishim një letër, sigurisht. Po, për shembull, për
16 të kuptuar dinamikat mes NATO-s dhe çfarë pritej prej nesh
17 konkretisht, domethënë, ishte që të krijonim një ide, një
18 panoramë të Rezolutës 1244.

19 E kemi lexuar disa herë dhe ndonjëherë z. De Mello më
20 thërriste madje kur ishim në avion në Romë dhe më thoshte "Kam
21 një pyetje për këtë. Çfarë mendon për këtë?". Tani nuk më
22 kujtohen të gjitha hollësitë. Po më kujtohet që kemi kaluar
23 orë të tëra dhe kemi komunikuar për paragrafë të ndryshme të
24 Rezolutës 1244.

25 Nuk po them që rezoluta në vetvete ishte e paqartë. Se

1 kishte kontekstin politik. E kishim të qartë pse ishte krijuar
2 kjo rezolutë dhe cili ishte qëllimi kryesor dhe çfarë duhet të
3 pasqyronte kjo rezolutë, por ne donim të diskutonim dinamikën,
4 detajet, në mënyrë që të krijonim një përshtypje më të mirë
5 operacionale.

6 Dhe, z. Misetic, kjo ka qenë hera e parë kur Kombet e
7 Bashkuara kanë pasur mandat ekzekutiv, kjo ka qenë një
8 përgjegjësi e jashtëzakonshme për një SRSG që nuk ishte më
9 thjesht një administrator por *de facto* do të administronte një
10 territor - më falni - administrator ekzekutiv i një territori.
11 Prandaj që ai përpigjej që ta kuptonte sa më mirë këtë
12 rezolutë.

13 PY. Ju keni hyrë në Kosovë personalisht më 12 qershor 1999,
14 kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Ju e ndiqnit situatën në Kosovë përmes lajmeve, por
17 përpara se të shkonit vetë në Kosovë, ju nuk e kishit
18 konkretisht idenë se çfarë po ndodhte atje në terren, apo jo
19 dhe çfarë po ndodhte atje?

20 PË. E keni fjalën personalisht a kisha qenë unë më përpara
21 atje?

22 PY. Po.

23 PË. Jo, nuk kam qenë atje më përpara.

24 PY. Sepse në paragrafin 12 të deklaratës suaj, ju keni thënë

25 "... nuk kishim informacion të dorës së parë, veçanërisht

1 për fluksin e shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht atyre që
2 kishin mbetur brenda në Kosovë.”

3 PË. Mbase është nevoja ta sqaroj këtë. Në atë kohë unë punoja
4 për Zyrën për Koordinimin e Çështjeve Humanitare në varësinë e
5 z. De Mello që ka qenë nën varësinë e Sekretarit të
6 Përgjithshëm. Kjo ka qenë Zyra e Koordinimit Humanitar të
7 Kombeve të Bashkuara. Sigurisht, ne e njohnim shumë mirë në
8 terma të përgjithshëm kontekstin dhe fushatën ushtarake në
9 Kosovë dhe, sigurisht, që disa prej informacioneve që kishim i
10 kishim marrë nga lëvizjet humanitare, merrnim raporte të
11 përditshme lidhur me situatën.

12 Po nga sa më kujtohet, nuk e mbaj mend konkretisht në
13 cilin muaj, po mbase prill, maj, u pranua Këshilli i Sigurisë
14 dhe u bënë përpjekje për të krijuar një mision që të drejtohej
15 nga z. De Mello në fakt, për të hyrë në Kosovë. Dhe e mbaj
16 mend që kemi bërë një tur të shkurtër. Po, pra, e kam fjalën
17 që z. De Mello ka qenë atje më përpara me shefin e personelit
18 që ishte rus në asokohe, unë personalisht në atë mision nuk
19 kam qenë.

20 Por ne kishim një informacion të dorës së parë dhe ka
21 qenë shumë e vështirë për cilindo që të kishte prani fizike
22 atje. Ne nuk mund të ishim të pranishëm në të gjitha qoshet e
23 Kosovës në mënyrë të organizuar. Ka qenë UNHCR-ja, që kishte
24 zyrën për të trajtuar situatën me refugjatët dhe ata ishin të
25 mendimit që njerëzit duhet të qëndronin në vendet e tyre në

1 Kosovë dhe të mos largoheshin prej Kosovës. Sepse kjo ka qenë
2 gjatë fushatës, popullata civile në fakt u largua edhe UNHCR-
3 ja në një fare mënyre s'po e përballonte dot më situatën,
4 ishte tepër e ngarkuar edhe ne merrnim në atë kohë
5 informacione në kohë reale, por në nivel makro dhe jo në nivel
6 mikro.

7 PY. Do jem pak më konkret. Ju personalisht - ju, si person -
8 nuk keni pasur asnjë informacion lidhur me strukturën e UÇK-së
9 në 1998 apo 1999?

10 PË. Jo.

11 PY. Nuk ju informoi dikush për organizimin e UÇK-së?

12 PË. Jo.

13 PY. Atëherë a mund të themi që ju nuk keni asnjë bazë për të
14 vlerësuar dhe për të thënë nëse kishte një sistem komandimi
15 dhe kontrolli të strukturuar UÇK-ja?

16 PË. Jo, nuk kam marrë ndonjë informacion më herët në lidhje
17 me këtë.

18 PY. Po më pas ju informoj dikush?

19 PË. Jo, po ne pamë realitetin kur shkuam atje, kishte persona
20 që na prezantoheshin edhe komunitetit ndërkombëtar dhe më
21 herët dhe thonin që ne jemi persona që përfaqësojmë UÇK-në
22 edhe kishin edhe tituj. Dhe, nëse më kujtohen disa nga takimet
23 që kemi pasur edhe veprimet që janë ndërmarrë, kur i bënim
24 thirrje, për shembull, i bënim thirrje forcave tuaja, duhet të
25 dilni me deklarata publike, duhet të shkurtoni, domethënë,

1 duhet të shmangni dhunën, mos bëni, mos krijoni gjykata, këtë
2 ua kemi thënë të njëjtëve persona që thonin që jemi ne
3 udhëheqësit politikë. Ata asnjëri nuk kanë thënë që "Ne nuk
4 jemi ne personat përgjegjës për këtë". Por merrnin përsipër se
5 do t'i kryenin veprimet që ne u kërkonim. Pra, ne nuk kishim
6 arsye për të besuar se këta ishin personat që drejtonin,
7 organizonin, ishin përgjegjës për organizatën.

8 Dhe e përmenda dhe më herët në një dokument që ma
9 treguan, ka qenë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,
10 për shembull, që për ne ishte z. Çeku, kështu u prezantua të
11 paktën dhe më pas z. Thaçi u prezantua po ashtu si një
12 komandant i UÇK-së. Pra, unë po ju them, që këtu jemi të
13 bazuar në komunikimet që kemi pasur ne në Kosovë dhe në bazë
14 të pranisë sonë fizike atje, pra, në bazë të kësaj ne
15 supozonim që kishte një strukturë komande dhe kontrolli nga
16 këta persona dhe këta persona ushtronin disa role në këtë
17 strukturë.

18 PY. Që ta kuptojmë dhe një herë. Përpara 12 qershorit ju nuk
19 keni pasur dijeni për strukturën komanduese dhe kontrolluese
20 të UÇK-së, kështu?

21 PË. Kështu.

22 PY. Dhe ju e bazoni këtë dhe thoni që ka pasur një sistem të
23 strukturuar komande dhe kontrolli bazuar në përkrahimin që
24 sapo na bëtë?

25 PË. Po.

1 PY. Që ta sqarojmë dhe një herë, ju nga pikëpamja ushtarake a
2 ju ka dhënë njeri raport për strukturën e UÇK-së përpara 12
3 qershorit 1999?

4 PË. Jo.

5 PY. Jo, domethënë, nuk keni marrë?

6 PË. Jo, nuk kam marrë asnjë raportim të tillë.

7 PY. Ju keni qenë këshilltar juridik deri në gusht të 1999,
8 saktë?

9 PË. Shtator, më duket. Besoj se kam qenë një herë deri në
10 fund të korrikut, shkova dy javë në Nju-Jork, u riktheva për
11 rreth një muaj, mbase fundi i gushtit fillimi i shtatorit.
12 Konkretisht nuk më kujtohet.

13 PY. Do të rifreskojmë kujtesën tuaj atëherë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarisë që të
15 vendosë në ekran materialin DHT04968 deri në DHT04968. Kjo
16 është biografia që ju keni publikuar në faqen e internetit të
17 organizatës për emigracionin.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në tekst. Këtu.
19 Paragrafi i dytë nga fundi.

20 PY. Ku thotë, tek rreshti i dytë thotë nga qershori deri në
21 gusht të 1999 ju keni qenë këshilltar juridik për
22 Përfaqësuesin e Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm në
23 Kosovë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ju tregoj dhe një dokument
25 tjetër. Ju lutem të nxirrnin në ekran dokumentin që mban

1 numrin DHT019 deri në --

2 PY. Z. Strohmeier, a ju kujtohet që keni botuar një artikull
3 në gazetën amerikane të drejtës ndërkombëtare në 2001?

4 PË. Po, më kujtohet.

5 PY. Në rregull. Do ta vendosim artikullin në ekran.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem na jepni dhe
7 një herë ERN sepse nuk u reflektuam.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Është DHT04969-DHT04986.

9 PY. Fillimisht dua të them që artikulli është botuar në 2001,
10 dy vjet pasi jeni larguar nga Kosova. Ky është artikulli?

11 PË. Besoj se po.

12 PY. Thuhet: "Kolapsi dhe rikrijimi i një sistemi gjyqësor:
13 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe në Timorin
14 Lindor". Dhe është emri juaj këtu në fund Hansjorg Strohmeier.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë dhe në fund, ju lutem. E
16 zmadhojmë pak që të jetë pak më e dukshme më e lexueshme.

17 PY. Këtu keni shkruar nga në mes të paragrafit:

18 "Nga qershori deri në gusht të 1999, ka qenë këshilltar
19 juridik për SRSG-në në Kosovë."

20 E shihni?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, e pranoni që mund të jeni larguar në gusht?

23 PË. Ju thashë edhe më herët, që nuk më kujtohet saktësisht
24 kur jam larguar nga Kosova. Në qoftë se e kam thënë këtu,
25 atëherë i bie të jetë e saktë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj
2 pranimin e dokumenteve që përdora.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtime?

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Dokumenti me numër DHT04968 deri në DHT04968 pranohet.
8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
9 do të marrë numrin e provës 1D00225 dhe klasifikimi aktual
10 është publik.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dhe një dokument tjetër,
12 ishin dy.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
14 DHT04968 pranohet.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
16 numrin e provës 1D00226 dhe klasifikimi është publik.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Po shoh edhe orën.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të na e sqaroni ju lutem
19 nëse dokumenti i dytë, për dokumentin e dytë të kërkojmë vetëm
20 pranimin e faqes së parë apo të gjithë dokumentin sepse është
21 me 18 faqe?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do të përdorë edhe disa faqe
23 të tjera gjatë pyetjeve të mia dhe në fund mbase do kërkoj që
24 të pranohet dokumenti në tërësinë e vet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 60

1 kundërshtim që të pranohet i gjithë dokumenti?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për momentin
4 po vazhdojmë kështu siç thatë ju.

5 Dëshmitar, tani do të bëjmë gjysmë ore pushim. Ju lutem
6 largohuni nga salla e gjyqit. Dhe do të shihemi në orën 11.30.

7 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërpresim
9 këtu seancën deri në orën 11.30.

10 --- Pauza fillon në orën 11.02

11 --- Seanca rifillon në orën 11.31

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

13 Sekretare, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'ju
15 pyes në qoftë se mund ta lirojmë dëshmitarin e radhës, e kam
16 fjalën për dëshmitarin e radhës që ka numrin 4874? Për sot,
17 mund ta lirojmë?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Për sot, po.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po.

20 Lirojeni.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Ndërkohë që do sillet dëshmitari, a
22 mund të them që ne nuk kundërshtojmë dhënien e dëshmisë përmes
23 videolidhjes për dëshmitarin e radhës, Dëshmitarin 42714
24 [Sipas përkthimit].

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Faleminderit që na e bëtë me dije qëndrimin tuaj. Nuk është e
2 nevojshme që të dëgjojmë parashtimet nesër në mëngjes, kështu
3 që do të lëshojmë një urdhër që do të lejojmë paraqitjen
4 përmes videolidhjes të këtij dëshmitari.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 z. Strohmeier, do të vazhdojmë me pyetjet e z. Misetic,
8 Mbrojtësi i z. Thaçi.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës.
10 PY. Strohmeier, në mënyrë që të vazhdojmë aty ku e lamë,
11 përpara pushimit. Ju thatë që u larguat për dy javë për
12 Gjermani në një pikë të caktuar kohe, apo jo?

13 PË. Jo, për Gjermani, nuk ika në Gjermani, por në Nju-Jork.

14 PY. Atëherë, shkuat në Nju-Jork për dy javë. Kur ka qenë, kur
15 ka ndodhur kjo?

16 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht se sa ka qenë data, por më
17 kujtohet që ka qenë e premtë. Kam përshtypjen që ka qenë dita
18 e ngjarjes ose incidentit në Graçko. Pra, thashë, domethënë,
19 që mendohej që do largohesha atë ditë, por me sa më kujtohet,
20 e shtyva një dy ose dy ditë sepse m'u kërkua ta shtyja ikjen
21 time në Nju-Jork. Domethënë ndoshta një ose dy ditë pas kësaj
22 ngjarjeje. Jam larguar atëherë dhe mendoj që kam qenë në Nju-
23 Jork për dy javë.

24 PY. Pra, në fakt ju jeni larguar na Kosova në fund të gushtit
25 1999. Domethënë, keni, qëndruat në Kosovë pothuajse dy muaj e

1 gjysmë, dhe pastaj u larguat nga fundi i gushtit, apo jo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Tani, do flasim për takimet tuaja me z. Thaçi dhe me UÇK-

5 në. Keni dhënë dëshmi që keni marrë pjesë në takime të

6 rregullta midis SRBG-së [Sipas përkthimit] që domethënë

7 Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm dhe

8 Gjeneralit Jackson pak javë pasi ju mbërritët, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Sikurse ju dëgjuam edhe gjatë përgjigjeve të pyetjeve të

11 Prokurorisë, thatë që keni marrë pjesë gjithashtu edhe në

12 mbledhjet e Këshillit të Përbashkët të Zbatimit, për

13 demilitarizimin e UÇK-së, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Sa i takon Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, kush e ka

16 formuar këtë qeveri të Kosovës, pra Qeverinë e Përkohshme të

17 Kosovës?

18 PË. Nuk mund ta them se kush e ka formuar qeverinë.

19 PY. Mirë, kaq më duhet, nuk më duhet gjë tjetër. Kur është

20 formuar?

21 PË. Kam të njëjtën përgjigje.

22 PY. Kur është formuar Qeveria e Përkohshme?

23 PË. Ajo çfarë mund të them unë që na u dha një organigramë,

24 një strukturë organizative në takimin që kemi pasur në Hotelin

25 Grand ku jepej struktura e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës,

1 domethënë, që planifikohej që të krijohej një qeveri e tillë.

2 Pra, për ne nuk është se kishin thjesht fjalë që qarkullonin,
3 por kishim një lloj dëshmie, domethënë, kishim këtë dokumentin
4 për sa i takon synimit real të formimit të kësaj qeverie.

5 PY. Kur është formuar përpara ose pasi u kthyet në Kosovë?

6 PË. Takimi në Hotelin Grand ka ndodhur dy ose tre ditë
7 përpara se sa të mbërrinim ne. Dhe kjo është hera e parë që ne
8 jemi hasur me idenë e krijimit të Qeverisë së Përkohshme të
9 Kosovës, ose me ambicien ose synimin e krijimit të kësaj
10 qeverisjeje.

11 PY. Ta lëmë mënjanë pyetjen se kur jeni informuar, por po ju
12 bëj një pyetje konkrete, a mund të më thoni se kur është
13 krijuar Qeveria e Përkohshme të Kosovës?

14 PË. Këtë jua thashë dhe më përpara si përgjigje, ju thashë që
15 nuk e di se kur është krijuar.

16 PY. Ku, pse është formuar Qeveria e Përkohshme e Kosovës?

17 PË. Sipas përshtypjes tonë, Qeveria e Përkohshme e Kosovës
18 ishte pasqyrim i ambicies së të paktën udhëheqësve të UÇK-së
19 për të krijuar një qeveri, apo një administratë që ishte
20 projektuar jo nga UNMIK-u, ose jo nga Këshilli i Kombeve të
21 Bashkuara, por që ishte projektuar ose formuar nga personat e
22 vet.

23 PY. Ti thua që ishte përshtypja jonë. Kur thua përshtypja
24 jonë, për kë e keni fjalën?

25 PË. E kam fjalën për personat që kanë qenë të pranishëm në

1 këtë takim në Hotelin Grand, ose persona të cilët kanë folur
2 më vonë lidhur me këtë temë. Sepse që prej atij momenti e në
3 vijim ne ishim të informuar që ekzistonte ambicia për krijimin
4 e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

5 PY. Tani po ju pyes pse, domethënë cila ka qenë arsyeja pse
6 është formuar Qeveria e Përkohshme e Kosovës? Dhe kam
7 përshtypjen që ju thatë që përshtypja juaj ishte pasi
8 mbërritët në vend, apo jo?

9 PË. Ju më pyetët në qoftë se është krijuar përpara apo pas
10 kohës kur unë jam futur në Kosovë? Nuk e di, nuk e di
11 konkretisht. Nuk e di se cilat kanë qenë aktet themeluese të
12 Qeverisë së Përkohshme. Megjithatë, ajo çfarë mund t'ju them
13 unë që në këtë takim, domethënë, në takimin që bëmë në Hotelin
14 Grand, na u dha ideja ose struktura organizative, dhe mund ta
15 them që z. Thaçi ishte aty dhe kishte dhe persona të tjerë të
16 pranishëm në sallë. Nuk më kujtohet ekzaktësisht se kush ka
17 qenë, por besoj që ka qenë edhe z. Selimi, në mos gaboj.
18 Megjithatë, jam i sigurt që z. Thaçi e ka bërë prezantimin e
19 kësaj ambicieje.

20 Që prej atij momenti e në vijim, ne ishim në dijeni të
21 faktit që ekzistonte ambicia e kësaj pjese ose këtyre
22 individëve të paktën që ishin të pranishëm aty, për krijimin e
23 qeverisë ose mbase edhe ideja ose ambicia e UÇK-së që të
24 krijohej një qeveri e përkohshme e Kosovës që ishte e ndryshme
25 nga administrata që mendohej që të krijonim dhe të themelonim

1 ne sipas rezolutës 1244. Sa i takon arsyes se pse është
2 krijuar, ishte përshtypja jonë, e theksoj dhe një herë, që
3 ishte përshtypja jonë që kjo ishte një lëvizje për të krijuar,
4 për të themeluar, një administratë të projektuar prej tyre, të
5 krijuar prej tyre dhe me kërkesë të tyre. Dhe në, një
6 administratë që do të ishte nën komandën ose kontrollin e
7 tyre. Kjo ishte përshtypja jonë.

8 Sa i takon pyetjes pse, ose cilat ishin elementët
9 përbërës, themelues, në qoftë se ka pas ndonjë dokument ose
10 një asamble që ka marrë vendimin për themelimin, këtë nuk e
11 di.

12 PY. A është e drejtë të thuhet që përpara Rezolutës 1244,
13 Kombet e Bashkuara nuk kanë pasur asnjë rol për negocimin e
14 një zgjidhjeje politike në konfliktin, për konfliktin në
15 Kosovë? Është e drejtë të thuhet kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po. Mendoj se është e saktë.

17 PY. Në Konferencën e Rambujesë Kombet e Bashkuara nuk kanë
18 qenë të përfaqësuara, apo jo?

19 PË. Me thënë të drejtën, nuk e di. Ajo çfarë di unë është që
20 ditët e fundit, pra, shumë pak kohë përpara stacionimit tonë,
21 ose armëpushimit, ajo çfarë di unë është që Kofi Annan siguroi
22 mandatin e Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë që prezumimi ynë që
23 ka të bëjë me pyetjen që bëtë juve sa i takon pranisë fizike
24 ose përshtypjes që kemi pasur ne në terren, detyra në fillim
25 fare iu la OSBE-së ose KVM-së, Misionit Verifikues të Kosovës.

1 Për sa i takon arsyes nuk mund të them që ishim të befasuar,
2 se e dinim, kishte disa ditë që e dinim. Megjithatë, ky ishte
3 një rol që nuk është se ne, për të cilin nuk është se ne u
4 përgatitëm për tre muaj, ose për katër muaj. Nuk e di në qoftë
5 se Kofi Annan ose dikush tjetër nga Kombet e Bashkuara kanë
6 qenë në Rambuje. Këtë nuk di t'jua them.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar i seancës, do ju
8 kërkoja që të paraqisnit në ekran provën 1D69.

9 PY. Z. Strohmeier, tani do shohim një dokument i cili është
10 një marrëveshje që është, për të cilën është rënë dakord në
11 Rambuje për sa i takon krijimit të Qeverisë së Përkohshme të
12 Kosovës. Do ju kërkoja që të lexonit dokumentin në anglisht.
13 Nëse e lexoni dokumentin, besoj që do lexoni që Qeveria e
14 Përkohshme është krijuar nga tre palë: nga UÇK-ja, ose nga z.
15 Thaçi, domethënë në kuptimin që është nënshkruar nga z. Thaçi
16 në emër të UÇK-së, dhe pastaj pala e dytë është LDK-ja, në
17 emër të cilës ka nënshkruar z. Rugova, dhe LBD-ja për të cilën
18 ka nënshkruar Rexhep Qosja.

19 Në të thuhet që është vendosur që të krijohet Qeveria e
20 Përkohshme e Kosovës dhe kjo qeveri ka mandatin për të
21 qeverisur deri në zgjedhjet e para të lira në Kosovë dhe se
22 mandati për të formuar qeverinë është në pajtim të ndërsjellë
23 të përfaqësuesve, të një përfaqësuesi të UÇK-së.

24 "Grupet politike kanë përfaqësim të barabartë në qeveri,
25 dhe kanë edhe mundësinë e anëtarëve të pavarur potencialë."

1 Kjo është hera e parë që e shikoni këtë dokument, apo jo,
2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Përfundimet që ju përcaktoni në deklaratën tuaj pse është
5 krijuar Qeveria e Përkohshme, në fakt është formuar pa pasur
6 njohuri faktike për historikun se si është krijuar Qeveria e
7 Përkohshme, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të kalojmë te një dokument
10 tjetër është dokumenti DHT04955 deri në DHT04967.

11 PY. Do shohim një artikull tani, Dëshmitar, ku diskutohet
12 krijimi i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky është një fragment i marrë nga
14 Raporti i Krizës në Ballkan. Të shohim konkretisht faqen
15 DHT04961. Mendoj që është faqja 7 e versionit në PDF, nga 13
16 faqe gjithsej.

17 PY. Të shohim paragrafin e tretë në fillim, thuhet që:

18 "Në të njëjtën kohë të informuar për dështimin e tyre për
19 të mos paraqitur një front të përbashkët të besueshëm në
20 Rambuje, UÇK-ja dhe LDK-ja u pajtuan që të krijonin një qeveri
21 të re në hije. Në këtë strukturë të re, Rugova do të mbetej
22 president, ndërsa Thaçi i UÇK-së është emëruar si
23 kryeministër. Humbësi është Bujar Bukoshi i cili ka qenë
24 kryeministër në ekzil, i cili që prej vitit 1992 ka qenë i
25 izoluar nga Rugova dhe është konsideruar si kundërshtar i UÇK-

1 së. Ai do të detyrohet që të qëndrojë jashtë, ose ajo çfarë
2 është më e rëndësishme, që të dorëzojë kontrollin e rezervave
3 të cilat janë mbledhur nga jashtë.”

4 Dhe ndërkohë vazhdohet më tej në dokument ku thuhet që:

5 “Ndërkohë që UÇK-ja dhe LDK-ja kanë gjetur arsye të
6 përbashkëta, kanë rënë dakord, testi i vërtetë do jetë që UÇK-
7 ja të mos i kalojë këto vijat e përcaktuara qartë.”

8 E lexuat, besoj apo jo, Dëshmitar? A mund të na thoni që
9 -- pra, ky është një artikull i cili është botuar në 1999. A
10 keni parë ndonjë gjë më përpara këtij artikulli që të jepen
11 shpjegime të tilla sa i takon përbërjes së Qeverisë së
12 Përkohshme të Kosovës, Dëshmitar?

13 PË. Jo.

14 PY. Përpara sot, përpara ditës së sotme, a e keni ditur ju që
15 z. Rugova ka qenë bashkëkrijues ose bashkëthemelues i Qeverisë
16 së Përkohshme të Kosovës?

17 PË. Jo.

18 PY. Në rregull.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do kërkoja që ky dokument të
20 mund të pranohej në prova gjyqësore.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
22 kundërshtim për pranimin e këtij dokumenti?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, vetëm faqen
24 6 dhe 7 mund të kërkojë avokati që të pranohet si provë
25 gjyqësore, se në të kundërtën nuk tha asgjë dëshmitari lidhur

1 me pjesën tjetër të dokumentit, dhe dokumenti është 13 faqe.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Dokumenti DHT04955, faqet 6 dhe 7 pranohen si prova gjyqësore.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Në këtë

5 rast dokumenti DHT04960 dhe DHT04961 -- do e them dhe një

6 herë. Atëherë, DHT04961 do të pranohet si provë me numrin

7 1D00227. Klasifikimi është publik.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja

9 gjithashtu që të pranohet edhe ballorja, ballina, faqja

10 kryesore, në mënyrë të tillë që të jetë më e qartë se për

11 çfarë flasin këto dy faqe.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë

13 kundërshtim lidhur me këtë?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim lidhur

15 me këtë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 Atëherë, në këtë provë do të përfshihet edhe faqja e parë,

18 ballina, me numër 4955.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem paraqisni në

20 ekran provën 1D149 -- më falni 148.

21 PY. Z. Strohmeyer, ky është një kabllogram i Departamentit të

22 Shtetit, është një departament [Sipas përkthimit] rreth dy

23 muaj përpara se të keni shkuar juve në Kosovë, mban datën, pra

24 është i prillit të 1999.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, do të shikojmë faqen

1 DHT09461 [Sipas përkthimit]. Është një bisedë, pra, kjo është
2 një pjesë që përshkruan bisedën midis Madeleine Albright,
3 Sekretarja e Shtetit dhe përfaqësuesve të UÇK-së. Edhe një
4 herë, për Sekretarinë është dokumenti DHT04961. Jo, ju kërkoj
5 ndjesë se dhashë referencën e gabuar. Atëherë, referenca është
6 DHT01539. Të kalojmë në fund të këtij dokument.

7 PY. Thuhet:

8 "Çështje politike.

9 "Sekretarja Albright theksoi nevojën për një qeveri të
10 përkohshme kosovare me bazë të gjerë. Kishte, ishte e
11 rëndësishme sipas saj që të kontaktohej me Rugovën. Ndërkohë
12 që nuk mund të njihej Qeverisë së Përkohshme, ne dëshirojmë që
13 në praktikë të punojmë me të", thotë Albright.

14 "Ne jemi të gjithë të paqartë sa i takon statusit të
15 Rugovës. Ai duhet që të jetë i përfshirë për sa i takon
16 deklaratave të mëhershme të tij për mbështetjen e një
17 marrëveshjeje politike."

18 Atëherë, edhe një herë pyetja për juve është kjo,
19 Dëshmitar, që ju nuk e keni ditur që Qeveria e Përkohshme ka
20 pasur mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo jo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Nuk kam qenë i njohur, nuk kam pas dijeni për dokumentin
23 që sapo ju më treguat.

24 PY. A keni qenë në dijeni ju, a keni ditur ndonjë gjë lidhur
25 me atë se cilat kanë qenë planet për Kosovën e pasluftës,

1 përveç asaj që ka qenë negociuar në kuadër të rezolutës 1244?

2 PË. Jo.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë që të
4 paraqesë në ekran deklaratën e dëshmitarit, z. Strohmeier, që
5 është prova P1968, paragrafin 25-26, në versionin në PDF është
6 faqja 7. Kalojmë tek paragrafi 26.

7 PY. Z. Strohmeier, mund ta lexoni pa zë këtë pjesën dhe
8 pastaj na thoni kur ta keni lexuar.

9 PË. E keni fjalën për paragrafin 25 dhe 26.

10 PY. Po. Për këto paragrafë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër në
12 anglisht.

13 DËSHMITARI: E përfundova paragrafin 26, do që të vazhdoj
14 me paragrafin 27?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, mjafton me aq.

16 PY. A është e drejtë të thuhet, z. Strohmeier që juve i keni
17 bërë konstatimet e dhëna në paragrafin 25 [Sipas përkthimit]
18 dhe 26 mbështetur në atë çfarë ju mendoni se ishte e drejtë
19 dhe nuk keni pasur informacionin që e patë sot?

20 PË. Po.

21 PY. Pra, është e pasaktë ajo çfarë keni thënë ju, pra
22 përfundimi që UÇK-ja kishte krijuar në mënyrë të njëanshme
23 Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, kështu?

24 Pra, në paragrafin 26, për ta bërë më të qartë ju thoni
25 që:

1 "Për këtë shpjegim, reagimi i Thaçit dhe të drejtuesve të
2 tjerë të UÇK-së " --

3 PË. A mund të më thoni -- ta shoh dhe një herë tjetër në
4 fillim të 26?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. I lutem Sekretarit të kalojë
6 tek faqja më përpara për të lexuar 26.

7 PY. Aty thoni që:

8 "... unë shpjegova përmbajtjen e ... Rezolutës 1244 të
9 Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që ishte se OKB-ja ishte i
10 vetmi autoritet qeverisës legjitim në Kosovë. Reagimi i Thaçit
11 dhe i udhëheqësve të tjerë të UÇK-së ndaj këtij shpjegimi
12 ishte i qartë. Ata kishin krijuar në mënyrën të njëanshme atë
13 që ata e quanin Qeveria e Përkohshme e Kosovës ... e cila
14 përbëhej kryesisht prej përfaqësuesve të UÇK-së.

15 "Qeveria e Përkohshme e Kosovës ishte krijuar për të
16 ushtruar kontroll në Kosovë për përjashtimin e pranisë
17 ndërkombëtare apo të organizatave, partive politike të tjera
18 etnike shqiptare."

19 Pra, e gjithë kjo pjesa është gabim, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Kështu më kujtohet. Sikurse e thashë, kjo pasqyron atë
21 çfarë më kujtohet mua. Mendoj se gjëja thelbësore këtu --

22 PY. Ju lutem, përgjigjuni njëherë pyetjes që ju bëra pastaj
23 bëni shpjegimin. Pra, ajo çfarë thashë unë që e gjitha kjo që
24 lexova është e gabuar, apo jo?

25 PË. Kështu më kujtohet mua. Juve sapo më paraqitët dokumente

1 që të paktën prej këndvështrimit të arritjes së këtyre
2 marrëveshjeve për sa i takon qeverisjes së përkohshme të
3 Kosovës, mund të sugjerojnë që ajo çfarë më kujtohej mua mund
4 të mos qenë, mund të mos kenë qenë të sakta. Që në fakt kjo ka
5 qenë thjesht një ide e UÇK-së, pra nuk është se ka qenë, le të
6 themi, ide e vetme e UÇK-së.

7 PY. Do t'ju bëj një pyetje ndryshe. Ju jeni Gjykatës në
8 Gjermani. Ose të paktën keni qenë i tillë në Gjermani. A
9 pajtoheni me mua që nuk është e drejtë të bëhen supozime të
10 tilla pa pasur informacion të plotë?

11 PË. Ajo çfarë dua që të përsëris dhe një herë tjetër është që
12 me sa më kujtohet mua, ky ka qenë një takim dhe kjo është
13 përshtypja që më është krijuar mua në këtë takim, këtë po them
14 unë, këtë po pasqyroj. Nuk po komentoj në qoftë se ky ka qenë
15 një përfundim i shpejtuar i mbështetur jo në të dhëna të
16 plota. Ndoshta kështu mund të rezultojë sot nga pikëpamja
17 juaj, por në qoftë se më lejoni dua të them që ajo çfarë nuk
18 thoni ju, nuk përmendni ju është që ajo çfarë ka ndodhur
19 përpara Rezolutës 1244 ka qenë një gjë shumë e rëndësishme dhe
20 ka ndryshuar gjithë situatën. Kjo është referenca jonë, dhe
21 kjo është pika gjykuese jona për këtë.

22 PY. Pra, ju lutem, më lejoni të ndërhyj dhe me këtë rast dua
23 t'ju them që nuk mund të flasim mbi njëri-tjetrin, se duhet që
24 të zbardhet procesverbali dhe duhet të na ndjekin edhe
25 përkthyesit.

1 Megjithatë, edhe një herë tjetër, po them që në
2 paragrafin 26 dhe në fakt në Shënimin Përgatitor numër 1, në
3 paragrafin 14, i keni bërë një korrigjim dhe thoni që:

4 “‘Qeveria e Përkohshme e Kosovës është krijuar si një
5 ushtrim kontrollues në Kosovë ...’ dhe ju thoni se ky është
6 një përfundim që ju keni nxjerrë si rezultat i disa
7 konstatimeve të ndryshme, në momente të ndryshme, gjatë
8 periudhës kur keni qenë në Kosovë.”

9 Domethënë, a është e saktë që ju e keni nxjerrë këtë
10 përfundim jo vetëm nga ky takim por në disa gjëra që keni parë
11 gjatë kohës kur keni qenë në Kosovë, kështu?

12 PË. E saktë.

13 PY. Në rregull. Ajo çfarë është e vështirë për mua për të
14 kuptuar ka të bëjë me paragrafin 26. Këtu ju thoni -- atëherë,
15 te fjalia e parë ju shpjegoni rezolutën 1244, dhe ju thoni që:

16 “Reagimi i Thaçit edhe i udhëheqësve të tjerë të UÇK-së
17 ishte i qartë.”

18 Dhe tani po na thoni që kjo ishte një përshtypja jua që
19 e krijuat aty. Pra, a mund të na thoni tani se çfarë reagimi
20 ka bërë z. Thaçi që ishte i qartë për juve?

21 PË. Ju kërkoj ndjesë, ndoshta do ishte më mirë që të kalojmë
22 tek pjesa tjetër. Tek pjesa e mbetur e paragrafit 26. Ju
23 kërkoj ndjesë që na duhet të ndryshojmë faqen, por vazhdon
24 paragrafi. Këtu thuhet që ishte përshtypja jonë, dhe në fakt
25 këtë na e kishin thënë, na ishte deklaruar, që planet e tyre

1 ishin që të krijohej qeverisja, Qeveria e Përkohshme e
2 Kosovës, dhe ata prisnin që ne të ofronim mbështetjen tonë. E
3 thashë dhe më herët, nuk është se ata na thanë që "nuk keni
4 asnjë rol për të luajtur këtu", por keni thjesht rol
5 mbështetës dhe unë thjesht u kam theksuar që sipas rezolutës
6 1244, parashikohej një tjetër strukturë dhe një tjetër
7 realitet, i ndryshëm nga ajo çfarë na u prezantua.
8 PY. Në Shënimin Përgatitor 1, në paragrafin 13, ju thoni që
9 jeni shumë i sigurt që ky takim ka ndodhur në Hotelin Grand.
10 Por, thoni gjithashtu që nuk ju kujtohen hollësitë e tjera të
11 bisedës midis De Mello dhe Thaçit kur Thaçi ka bërë
12 prezantimin e strukturës organizative të qeverisjes së
13 përkohshme të Kosovës. A është kështu?
14 PË. Po.
15 PY. Domethënë, me fjalë të tjera juve nuk ju kujtohet
16 ekzaktësisht se çfarë ka thënë z Thaçi në përgjigje të
17 komentit që keni bërë juve sa i takon rezolutës 1244?
18 PË. Jo, fjalë për fjalë nuk më kujtohet. Por më kujtohet që
19 ka pasur një reagim dhe gjithmonë e kam pasqyruar këtë reagim
20 në deklaratat e mia. Reagimi ka qenë i tillë që parashikohej
21 një tjetër strukturë ose një tjetër, një tjetër strukturë
22 administruese e Kosovës që do të menaxhohej përmes Qeverisë së
23 Përkohshme të Kosovës dhe ku ne do të luanim një rol
24 mbështetës. Më kujtohet shumë qartë kjo nga takimi, sepse prej
25 atij momenti e në vijim, ishte e qartë që kjo ishte diçka që

1 ne duhej ta trajtonim, në mënyrë të tillë që të shmangnim një
2 sistem paralel apo një qeveri me institucione paralele. Pra,
3 ky ishte përfundimi im dhe përfundimi i të gjithë neve që
4 ishim në atë takim.

5 Nuk është se më kujtohet data, nuk më kujtohen shumë
6 hollësi të tjera, megjithatë ajo çfarë më kujtohet, e di,
7 domethënë, e di që ku ishte salla, dhoma ku u takuam, jam
8 shumë i sigurt në fakt që kemi qenë në Hotelin Grand, dhe
9 prandaj e kam thënë këtë gjë dhe e di që nuk ka qenë te Kodra
10 e Diellit, por ka qenë në Hotelin Grand. Sepse mënyra e
11 projektimit ose planimetrisë së brendshme në Kodrën e Diellit
12 ka qenë tërësisht e ndryshme nga ajo në Hotelin Grand.

13 PY. Në deklaratën tuaj ju thoni që ka ndodhur një javë pasi
14 jeni futur në Kosovë, apo jo?

15 PË. Besoj që ka ndodhur tre apo katër ditë pasi jam kthyer
16 mbrapsht në Kosovë.

17 PY. Në rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në paragrafin 25.

19 PY. Ju këtu thoni që:

20 "Ka qenë thuajse një javë pasi u kthyem në Kosovë që jemi
21 takuar për herë të parë me udhëheqësit e UÇK-së."

22 Ka qenë kështu, Dëshmitar?

23 PË. Po, këtë kam thënë.

24 PY. Pra, kjo i bie që të jetë diku rreth datës 19 qershor.

25 PË. Në qoftë se është një javë ose disa, mund të jetë edhe

1 disa ditë përpara, ose, nuk mendoj që ka qenë disa ditë më
2 vonë.

3 PY. Në qoftë se është disa ditë më parë, që mendoj keni të
4 drejtë, le të shfaqim në ekran dokumentin DHT03 -- 04937 deri
5 në 4930 [Sipas përkthimit].

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky dokument ka -- për periudhën
7 kohore të pranisë së Kombeve të Bashkuara në Kosovë nga 11
8 qershor deri në 12 korrik 1999. Kalojmë në faqen 3 të
9 versionit PDF, dhe "Data -- dita e 7: 17 qershor":

10 "Sergio Vieira de Mello *and* Gjenerali Jackson u takuan me
11 patriarkun e Beogradit i cili ishte në Prishtinë për të
12 diskutuar lidhur me eksodin, largimin e serbëve nga provinca."

13 "De Mello u takua gjithashtu me kreun e sapoemëruar të
14 Republikës Federale -- të Komisionit të Republikës Federale të
15 Jugosllavisë për Bashkëpunim dhe Ndërlidhje me Kombet e
16 Bashkuara, Nebojsa Vujovic, në Prishtinë. U takua gjithashtu
17 me tre partitë politike shqiptare të Kosovës, LDK, LDP, dhe
18 UÇK të cilët mbështetën Kombet e Bashkuara, Misionin e Kombeve
19 të Bashkuara në Kosovë dhe u angazhuan për të mbështetur një
20 demokraci shumëpartiake në provincë."

21 Tani, data 17 qershor përputhet pak a shumë me atë që ju
22 kujtohet juve lidhur me takimin e parë me UÇK-në, apo jo?

23 PË. Siç e thashë më parë, kërkoj ndjesë, nuk mund të them që
24 ka ndodhur më 17 qershor, por brenda pak ditësh, brenda asaj
25 jave të parë. Nuk ka qenë dita e parë apo e dytë, por disa

1 ditë më vonë, brenda kësaj periudhe.

2 PY. Këtu thuhet që personi -- dhe këtu i referohet UÇK-së si
3 parti politike. Pra, personi që vepronte në emër të krahut
4 politik të UÇK-së u angazhua në mbështetje të UNMIK-ut dhe në
5 mbështetje të një demokracie shumë partiake në Kosovë.

6 E saktë?

7 PË. Kështu lexohet në dokument.

8 PY. Pajtoheni që këto përfundime janë në njëfarë mënyre në
9 mospërputhje me atë që ju kujtohet juve lidhur me takimin e
10 parë me UÇK-në, ku sipas jush ata donin që të impononin
11 autoritetin e tyre dhe që UNMIK-u të ishte vartës i urdhrave
12 të tyre?

13 PË. Së pari, nuk mund të them nëse takim i datës 17 qershor
14 që përmendet këtu është i njëjti takim për të cilin fola unë.
15 Në qoftë se -- kjo nuk ishte takim me tre partitë së bashku,
16 ishte takim individual me UÇK-në dhe më kujtohet praninë e z.
17 Thaçi aty. E di që ka patur dhe të tjerë në dhomë, por nuk
18 mund, nuk jam në gjendje t'ju them saktësisht, kush saktësisht
19 dhe sa vetë ishin.

20 Por më kujtohet që ka patur takim tjetër vijues, takime
21 të tjera, në njërin prej tyre kam marrë pjesë, ku këta të tre
22 ishin në dhomën afër që ishte ngjitur me dhomën e PSSP-së,
23 selia kryesore fillestare, pra. Nuk e di a është i njëjti
24 takim apo jo.

25 Por sa i takon deklaratës "mbështetja për një demokraci

1 shumëpartiake në provincë", mund të jetë kështu, që njerëzit
2 në takime të tilla e kanë përmendur, kanë shprehur, patur dhe
3 raste të tjera kur është përmendur. Por kjo ka qenë dhe
4 realitet. Ishte dhe realiteti aty, dhe është krejt e mundur që
5 përshtypja që unë dhe të tjerët kemi krijuar, ishte, janë
6 përshtypje që kanë marrë parasysh faktorët përtej deklaratave
7 të udhëheqësve politikë në takime.

8 PY. Pra, ju po thoni që mund të jetë që përfaqësuesit
9 politikë të UÇK-së në një takim shprehen në mbështetje të
10 UNMIK-ut dhe një demokracie shumëpartiake dhe pastaj janë në
11 të njëjtën përfaqësuesit, pra janë, kërkojnë nga ana tjetër
12 nënshtrimin në një farë mënyre të UNMIK-ut dhe kërkojnë që të
13 marrin pushtetin në tërësi në Kosovë, nga, pra, që UÇK-ja ta
14 marrë këtë.

15 PË. Unë nuk e kam përdor fjalën "vartës" apo "nën të". Ajo që
16 do thoja është, që është e mundur që ata kanë parashikuar,
17 kanë paraparë një rol ndryshe mbështetje për Kombet e
18 Bashkuara, apo roli ekzekutiv i formimit, në formimin e
19 administratës. Por është e mundur që në atë kohë apo në takime
20 të ndryshëm gjëra të ndryshme të jenë diskutuar. Në qoftë se
21 ka qenë kështu, ky ka qenë takim ku Sergio Vieira de Mello
22 janë takuar me të tre prej tyre së bashku në një dhomë, dhe
23 mund të jetë që mesazhi është ndryshe nga mesazhi i dhënë në
24 seanca private. Po them që është e mundur. Realiteti në
25 terren, megjithatë ishte ndryshe nga ajo që shprehej në, apo

1 që është shprehur në këtë takim, ku parashihej më shumë një
2 rol mbështetës i Kombeve të Bashkuara ndryshe nga roli që
3 parashikohej në rezolutën 1244 pra.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të pranohet
5 si provë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Dëshmitari nuk ishte në
8 gjendje të identifikonte takimin në fjalë. Është dokument që
9 përbëhet nga 14 faqe. Në qoftë se është e mundur, pra, të
10 pranohet vetëm kjo faqe, për nevoja reference.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Për mua mjafton të pranohet kjo
12 faqe dhe ballina.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky do marrë
14 numrin DHT19 -- 0930. Cila është faqja tjetër?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faqja e parë është DHT04937, që
16 është ballina, dhe pastaj dokumenti në faqe dht04939.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
18 DHT04937 dhe DHT04939 pranohen.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto dy
20 faqe do marrim numrin e provës materiale 1d00228, klasifikuar
21 si publik.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Dëshmitar, ju lexuat paragrafin 26 ku thoni që UÇK-ja
24 ishte formuar "për të përjashtuar praninë ndërkombëtare dhe
25 çdo organizatë tjetër politike apo parti politike shqiptare".

1 A pranoni që Qeveria e Përkohshme ishte në fakt, në
2 realitet, formuar duke përfshirë edhe LDK-në?
3 PË. Nga dokumentet që më treguan në Rambuje, demonstrojnë
4 këtë gjë, pra. Po.

5 PY. Në paragrafin 27.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për nevoja -- që dëshmitari të
7 jetë në gjendje ta shohë, është dokumenti P1968, versioni PDF
8 faqe 8. Paragrafi 27. Pak më poshtë. Më duket që është faqja
9 tjetër, po. Në këtë paragraf -- mund ta heqim dokument tjetër.
10 PY. Në këtë paragraf, nga mesi i paragrafit, ju thoni --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
12 identifikoni paragrafin me numër?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Paragrafi 27, për procesverbal.

14 PY. Aty thuhet: "UÇK-ja --

15 Gjashtë rreshta më poshtë:

16 "UÇK-ja është e shumë mirinformuar për vakumin politik në
17 Kosovë, dhe mendoj që motivimi kryesor për kundërshtimin e
18 autoritetit të OKB-së në Kosovë nuk ishte për të, më shumë për
19 të kundërshtuar autoritetin e tyre, por për të lëvizur shpejt
20 dhe për të mbushur vakumin kundër grupeve të tjera kosovare,
21 kryesisht LDK-ja dhe Ibrahim Rugova, duke u vendosur në
22 terren. Pra, me fjalë të tjera UÇK-ja nuk ishte që donte të
23 kundërshtonte OKB-në kryesisht, por donte të, kryesisht të
24 vendoste autoritetin e vet politik në Kosovë."

25 Edhe këtu, siç e pamë, z. Rugova ka bashkëkrijuar

1 Qeverinë e Përkohshme dhe tani e dini këtë, është kështu?
2 PË. Mendoj që bashkëkrijimi, kjo është diçka që ka ndodhur në
3 Rambuje. Pas Rambujesë ishte Rezoluta 1244 dhe kjo ka
4 ndryshuar gjithçka. Kjo ishte në realitet. Pra pas rezolutës
5 1244, nuk kundërshtoj që siç ma treguat edhe ju në dokumente,
6 është krijuar Qeveria e Përkohshme.

7 Por ajo që mund t'ju them është që nuk më kujtohet një
8 takim në të cilin LDK-ja na ka prezantuar neve një organigramë
9 të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Pra, pas Rezolutës 1244,
10 duke krahasuar ambicien dhe përmbajtjen e 1244, pra,
11 rezolutës, ku linte autoritetin, pushtetin ekzekutiv dhe
12 administratën në duart e UNMIK-ut, prezantimin neve me një
13 propozim për strukturën e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës,
14 nuk mund të vlerësohej ndryshe përveçse si kundërshtim i
15 mandatit që na ishte dhënë nga këshilli i sigurimit.

16 PY. Organigrama që prezantoi z. Thaçi, a përfshinte
17 rezervimin e vendeve për LDK-në?

18 PË. Siç e thashë më parë nuk më kujtohen hollësitë e
19 organigramës që na u prezantua.

20 PY. Kjo është fakt i rëndësishëm në vlerësimin, arritjen e
21 përfundimit tuaj lidhur me Qeverinë e Përkohshme dhe që motivi
22 i UÇK-së ishte për të përjashtuar LDK-në?

23 PË. Nuk -- gjithashtu ajo që po them, nuk mendoj që deklarata
24 ime, në deklaratën time thuhet diçka e tillë, pra lidhur me
25 strukturimin e organigramës, përveç asaj që mendova që ishin

1 vetëm pjesëtarë të UÇK-së ata që renditeshin aty. Pjesëtarë të
2 UÇK-së që e prezantuan këtë neve, dhe kam këmbëngulur në këtë.

3 Dhe përfundimi nga ana jonë, pra konkludimi nuk mund të
4 ishte ndryshe përveç asaj që UÇK-ja paraqiste një sfidë për
5 autoritetin e UNMIK-ut dhe rezolutën 1244.

6 PY. Ju nuk --

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
8 ekran provën materiale 019752 deri në 019753, ju lutem. Dhe që
9 të mbajmë njëkohësisht në anën e djathtë të ekranit deklaratën
10 e dëshmitarit. Në qoftë se mund të shohim pak më poshtë.

11 PY. Ky është artikull përpara arritjes suaj në Kosovë, 21 maj
12 1999. Ku thotë:

13 "Ushtria -- udhëheqësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
14 Hashim Thaçi, bën një konferencë për shtyp në Tiranë më 21
15 maj. Ai tha që ka ftuar shqiptarët etnikë të moderuar,
16 presidentin Ibrahim Rugova, për bisedime në Tiranë për një
17 platformë politike të bashkuar."

18 Ju nuk keni ndonjë dijeni lidhur me këtë përpara që të
19 arrinit në Kosovë?

20 PË. Nuk më kujtohet të kem parë këtë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, kalojmë në 1D28 -- 1D88,
22 ju lutem.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Për qartësi -- sigurim,
24 a duhet t'i heqim të dy dokumentet?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Hiqni dokumenti në anën e majtë,

1 ju lutem, dhe mbani tjetrin.

2 PY. Tani ky është artikull kur ju ishit në Kosovë dhe i thatë
3 Prokurorit që keni pranuar raporte gjatë kohës që ishit aty në
4 Kosovë. Dhe aty thuhet: "Udhëheqësi i shqiptarëve të Kosovës
5 dënon dhunën", kjo është më 6 korrik 1999, ka të bëjë me
6 komente nga z. Thaçi i cili thotë që:

7 "... distancohet të martën nga dhuna që ka prekur
8 provincën e jugut në javët e fundit.

9 "Deklarata e Thaçit vjen pas, pasi që udhëheqësit e
10 serbëve, pakicave serbe, kërcënuan që do të tërhiqnin
11 bashkëpunimin , të tërhiqeshin nga bashkëpunimi tyre me
12 shqiptarët etnikë për shkak të sulmeve që kishin ndodhur
13 kundër pjesëtarëve të komunitetit të tyre.

14 "Thaçi, udhëheqësi i gueriles së UÇK-së i cili luftoi
15 kundër pushtetit serb dhe tani kryeministër i Qeverisë së
16 Përkohshme të vetëshpallur, dënon plaçkitjet, vjedhjet dhe
17 veprimet e papërgjegjshme.

18 "Ai gjithashtu paralajmëroi udhëheqësin etnik rival
19 shqiptar Ibrahim Rugovën në Lidhjen Demokratike të Kosovës
20 duke i thënë atij se do t'u jepte vetëm deri në fund të javës
21 për të marrur pozicionet e tyre në Qeverinë e Përkohshme.

22 "Thaçi këmbënguli që UÇK-ja nuk ishte e përgjegjshme për
23 sulmet kundër serbëve që, të cilët ishin sulmuar nga shqiptarë
24 etnikë që kërkojnë të hakmerreshin sipas dhunës së serbëve
25 ndaj tyre."

1 Ju a keni, ishiti në dijeni që z. Thaçi po i bënte thirrje
2 shqiptarëve që të bashkoheshin në qeveri?

3 PË. Nuk e di më shumë, nuk kam informacion për këtë.

4 PY. Përfundimet tua në paragrafin 26, 27, lidhur me
5 Qeverinë e Përkohshme që është e, që po krijohet, me qëllim të
6 përjashtimit të partive politike shqiptare është bërë bazuar
7 në informacione të paplota. Është kështu?

8 PË. Ajo që përshkrova më herët dhe po ju jap përshtypjet e
9 mia dhe përfundimet, u bazua në prezantimin në fjalë të
10 qeverisë, organigramës së Qeverisë së Përkohshme nga z. Thaçi.

11 PY. A është e saktë të themi që përfundimet në të cilat keni
12 arritur janë bazuar në informacione të paplota?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pyetja është bërë dhe ka marrë
14 përgjigje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
16 Mund t'i përgjigjet pyetjes.

17 DËSHMITARI: Nuk dëshiroj të -- natyrisht askush nuk
18 pretendon që kishim të gjitha informacionet në dispozicion në
19 Kosovë apo përpara ardhjes sonë në Kosovë, dhe as unë s'i kam
20 patur të gjitha. Por mund të them që ajo që kam deklaruar këtu
21 ishte përshtypja ime, siç është shënuar aty, për arsye të
22 cilat po përpiqem të shpjegoj.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin,
24 dokumentin në anën e majtë të ekranit. Dhe kalojmë në
25 paragrafin 33 të deklaratës së dëshmitarit.

1 PY. Në këtë paragraf thuhet që:

2 "Kam marrë pjesë në takime të rregullta mes PSSP-së dhe
3 komandantit të KFOR-it, Gjenerali Mike Jackson, në javët e
4 para pas arritjes time aty. Qëndrimi i KFOR-it ishte se ata
5 nuk ishin në Kosovë për të mbajtur rendin dhe ligjin. Ishin
6 aty për të parandaluar përshkallëzim të një situate të
7 paqëndrueshme, pas pushimit të konfliktit të armatosur. Dhe
8 përgjegjësia e UNMIK-ut ishte të mbante rendin dhe ligjin dhe
9 të rindërtonte infrastrukturën e Kosovës."

10 Tani, bazuar në këtë, sipas kësaj, komandanti i KFOR-it
11 tha që konflikti i armatosur kishte pushuar, përfunduar. Kur e
12 ka thënë këtë?

13 PË. Ka patur një armëpushim -- ndoshta teknikisht nuk është
14 termi i duhur, por deklarimi kur ishte? Më 9 qershor që --
15 pastaj më 10, në Nju-Jork u vendos që të mos kishte më veprime
16 të armatosura nga NATO-ja. Tani nuk më kujtohet që ai ishte,
17 cili ishte termi ligjor apo ishte pushimi i akteve të
18 armiqësore apo armëpushim, por pas datës 9, 10 qershor
19 konsiderohej si situatë ndryshe.

20 PY. Pra -- pra, deri më 10 qershor konsiderohej konflikti i
21 armatosur, pas datës 10 qershor konflikti i armatosur kishte
22 përfunduar, është kështu?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim, kjo është pyetje
24 spekulative, dhe kërkon që të dilet në përfundime.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në deklaratën e tij, z.

1 Kryetar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

3 DËSHMITARI: Po, ne kishim përshtypjen, me fjalë të
4 thjeshta, që kishte konflikt, veprime të armatosura, konflikt
5 të armatosur në Kosovë, dhe që dislokimi i KFOR-it dhe
6 rezoluta e Kombeve të Bashkuara kishte për qëllim që të
7 parandalonte shpërthimin e një konflikti të armatosur tjetër.
8 Në çfarë forme që mund të paraqitej, në çfarëdo lloj forme.

9 Z. MISETIC: [Përkthim]

10 PY. Po, por po shohim datën dhe e kuptoj që nuk ka përgjigjur
11 [Sipas përkthimit] paraprake se më 10 qershor ishte data që
12 ndan --

13 PË. Mendoj që ishte diçka rreth 9 qershorit, nuk më kujtohet
14 tërësisht, por më 10 qershor ishte dita e madhe për neve, në
15 një farë forme ishte dita kur -- kjo është arsyeja pse jemi
16 nisur më 10 qershor, teknikisht mund të jetë deklaruar si e
17 tillë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
19 ekran dokumentin 1D209 dhe mbajmë deklaratën në anën e djathtë
20 të ekranit.

21 PY. Ky është një raport i Sekretarit të Përgjithshëm të
22 Kombeve të Bashkuara.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
24 SPOE00000755. Ky është raporti.

25 PY. Ky dokument mban datën 12 korrik 1999. Raporti i

1 Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara,
2 Administrata e Përkohshme e UNMIK-ut, Misioni i Administratës
3 së Përkohshme të UNMIK-ut në Kosovë. Cili ishte roli i UNMIK-
4 ut për të ndihmuar Sekretarin e Përgjithshëm për të përgatitur
5 raportet e përkohshme?

6 PË. Do të thoja që drafti thelbësor është përgatitur ndoshta
7 në Kosovë nga stafi i UNMIK-ut, por nuk jam në gjendje t'ju
8 them tani kush në Nju-Jork ka ndërhyrë apo ka patur rol në
9 versionin përfundimtar apo vlerësimet politike që janë marrur
10 parasysh. Kjo është praktika standarde për të gjitha misionet
11 e Kombeve të Bashkuara. Kjo nuk do të thotë që versioni
12 përfundimtar përmban të gjitha fjalët e informacioneve që
13 vijnë nga terreni.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
15 paragrafin 8, më duket. 88, është faqja tjetër kjo, po. Në
16 rregull.

17 PY. Dëshmitar, në paragrafin 88 këtu, lexon:

18 "Problemi, një problem i veçantë dhe i theksuar i të
19 drejtave të njeriut në Kosovë është pasiguria e vendndodhjes
20 së pjesëtarëve të familjes që janë zhdukur gjatë konfliktit.
21 Rrëmbimet vazhdojnë pas përfundimit të konfliktit."

22 Tani, ky dokument është përgatitur më 12 korrik dhe
23 thotë, "pas konfliktit, përfundimit të konfliktit", bazuar në
24 përgjigjen tuaj paraprake, a duhet të kuptojmë që bëhet fjalë
25 për datën 10 qershor, përfundimi i konfliktit, pra?

1 PË. Duke parë paragrafin në tërësi, mendoj që bëhet fjalë më
2 shumë për veprime armiqësore apo dhunë e shkaktuar nga forcat
3 në terren. Ndërsa data 10 qershor shënon ditën kur, e veprimit
4 të NATO-s dhe për neve teknikisht kjo shënon përfundimin e
5 konfliktit, përndryshe nuk do të kishim shkuar aty.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim dhe një dokument tjetër.
7 Dokumenti i vitit 2001, që mban numrin 1d226.

8 Do ta bëj këtë gjë.

9 PY. Z. Strohmeier, ky është artikulli i shkruar nga ju në
10 vitin 2001.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të kalojmë në faqen 3,
12 poshtëshënimi 5.

13 PY. Në poshtëshënimin 5 ju citoni raportin e Kombeve të
14 Bashkuara që sapo ju tregova, 12 korrik 1999. Raporti i
15 Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, dhe thoni:

16 "Në fund të konfliktit të Kosovës, nga popullsia 1.7
17 milionë, pothuajse gjysma, 800.000, kishin kërkuar strehim
18 jashtë vendit, kryesisht në Shqipëri, në ish-Maqedoni dhe Mal
19 të Zi. Për më tepër, përveç kësaj 500.000 shqiptarë janë
20 zhvendosur brenda Kosovës."

21 Dhe ju citoni në këtë raport, këtë e thoni në raportin që
22 ju tregova, në paragrafin 8. Këto statistika i keni dhënë në
23 fund të konfliktit në Kosovë. Edhe një herë duke iu referuar
24 datës 10 qershor, a janë këto statistikat e refugjatëve deri
25 në 10 qershor pra, kjo është data?

1 PË. Sapo pashë faqen e parë dhe mendoj që në paragrafin e
2 parë ose të dytë i referohet datës 10 qershor si përfundimi i
3 fushatës ajrore, apo diçka e tillë. Pra kur thoni në
4 përgjithësi kjo ka qenë pika e referencës për neve, data 10
5 qershor.

6 PY. Në rregull.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin në anën e
8 majtë të ekranit.

9 PY. Ju trajtoni dhe krimet kundër pakicave në paragrafin 29
10 të deklaratës suaj.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë, kthehemi një faqe më
12 parë. Kërkoj, ndjesë faqja tjetër, në vijim. Kjo është.

13 PY. Këtu thoni:

14 "... kishte mungesë, anarki të plotë të shpërndarë, dhe
15 mungesë rendi, sepse nuk kishte gjë të organizuar, ligji dhe
16 forca civile e policisë nuk e, nuk ishte funksionale".

17 Pra kjo bazohej në takimet e sigurisë dhe, që keni patur
18 me NATO-n dhe KFOR-in, apo jo?

19 PË. Po. Në fillim fare, kur shkonim në këto takimet me KFOR-
20 in, mbledhjet, ishin OSBE-ja, ndërveprime, shkëmbime me
21 personat që ishin aty. Dhe kanë konfirmuar, konfirmojnë këto
22 përshtypje. Për këtë them takimet dhe mbledhjet e sigurisë me
23 KFOR-in dhe NATO-n. Pra, ishte një lloj mozaiku informacionesh
24 ku ne kishim shkëmbime me persona të ndryshëm, interlokutorë
25 të ndryshëm. Ishin ditët e para dhe kryesisht ishin takime me

1 raporte të NATO-s, KFOR-it dhe OSBE-së. Pastaj me kalimin e
2 kohës informacioni që ne merrnim, apo burimet e informacioneve
3 tona u zhvilluan edhe më tepër.

4 PY. Ju personalisht nuk keni qenë dëshmitar i dhunës ndaj
5 pakicave? Sulme ndaj pakicave?

6 PË. Po, por në të njëjtën mënyrë të çrregullt apo sporadike,
7 ashtu siç janë raportuar këtu. Ne kemi ecur me, lëvizur me
8 makinë nga Kodra e Diellit në Prishtinë në qytet dhe në anën e
9 majtë, kemi parë, gjë që ishte e zakonshme ato ditë -- një
10 lloj, një çift që merrnin plaçkat e tyre, i ngarkonin mbi
11 makinë -- shkronjat ishin cirilike, dhe ne arritëm në
12 përfundimin që bëhej fjalë për serbë që po largoheshin. Nuk e
13 di se, nuk e di se për çfarë ishim aty, por, për çfarë kishim
14 shkuar aty, dhe pastaj morëm diçka, nuk e di. Pastaj, 20
15 minuta më vonë kur po ktheheshim në Kodrën e Diellit, pas 20
16 minutash pamë që i njëjti vend ku kishim parë këtë çiftin po
17 digjej. U ndalua, folëm, biseduam me ata njerëz, me atë çift,
18 dhe ata thanë që dikush kishte hedhur një koktej molotov në
19 ndërtesën ku ishin objekti, por dhe në makinat, duke e djegur
20 atë pra. Dhe këta ishin serbë që donin të largoheshin.

21 Nuk e di nëse ka patur gjëra të tjera, por ishin të
22 informuar edhe për kërcënime personale kundër disa prej
23 pjesëtarëve joshqiptarë, përfshirë gjyqtarë. Ne kishim stafin
24 tonë, në një moment kam patur shoferin tim që më çoi në Shkup
25 dhe më tha që do largohet brenda dy tre ditësh, ai i përkiste

1 një pakice shqiptare -- joshqiptare, myslimane, të cilëve u
2 ishin thënë që s'kishin më vend aty.

3 Pra, kishte shumë gjëra të tilla. Nuk, nuk kam patur
4 mundësi që të vëzhgoj gjëra të tilla pa fund sepse nuk ishte
5 roli im që të shënoja incidente të tilla, por nga pozicioni im
6 avantazhoz kisha shkëmbime, ndërveprime dhe mund të shihja,
7 isha në gjendje të shihja këto lloj gjërash. Dhe natyrisht
8 pastaj kemi lexuar, kemi diskutuar këto raporte të drejtave të
9 njeriut dhe raporte e tjera që i kishim në baza ditore.
10 PY. Raportet që keni marrë ju, mes tyre përfshihen dhe
11 raportet nga Sandra Mitchell?

12 PË. OSBE-ja do të thojë. Sandra Mitchell më duket se ka qenë
13 drejtuese e Sektorit të të Drejtave të Njeriut të OSBE-së, dhe
14 mbase Rob Pavler ka qenë Drejtuesi i Çështjeve Juridike,
15 Gjyqësore, të OSBE-së. Sigurisht që ne takoheshim me të dy
16 këta persona për të marrë informacion. Ndonjëherë merrnim
17 informacione paraprakisht ose ndodhte që mund t'i kishim
18 lexuar në raporte të NATO-s, të KFOR-it, dhe këto informacione
19 i verifikonim për të kuptuar nëse bëhet fjalë për të njëjtin
20 incident. Pra, këto ishin aspektet që trajtoheshin në fillim.
21 PY. Do t'ju tregoj një video që është 38 sekonda.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të vendoset në ekran
23 materiali 1D76. Për kontekst, do t'ju them që është një video
24 e Pentagonit, flet një nga gjeneralët e Pentagonit përpara
25 mbërritjes në Kosovë, më duket se është data 5 qershor. Në

1 këtë video përshkruhen planet për futjen në Kosovë dhe çfarë
2 prisnin të gjenin atje.

3 DËSHMITARI: E keni fjalën për futjen e NATO-s --

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, më falni. Po, për futjen e
5 NATO-s e kisha fjalën.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Fakt është që unë nuk mendoj se Kosova do të jetë vend
8 shumë i gëzuar për serbët kur të hyjë NATO-ja, dhe nuk mendoj
9 se serbët do të duan të qëndrojnë aty, por do kthehen në
10 Serbi. Ne nuk e dimë sa e madhe është pakica serbe atje, mbase
11 rreth 100 000 persona, diçka më shumë. Por në momentin që do
12 kthehen shqiptarët e Kosovës, ne mendojmë se shumë prej
13 serbëve do të rikthehen në Serbi.

14 "Duket sikur po inkurajoni serbët që të, në Kosovë, të
15 largohen atëherë?

16 "Nuk po inkurajoj fare. Unë po them se çfarë presim ne
17 nga situata."

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Pra, ai thotë që: Ne parashikojmë që Kosova nuk do të
20 jetë një vend shumë i lumtur apo i gëzuar për serbët.

21 Ju keni marrë ndonjë instruktazh përpara se të hynit në
22 Kosovë ose gjatë kohës suaj në Kosovë?

23 PË. Ne jemi larguar nga Nju-Jorku më datë 10. Mbërritëm në
24 Romë në datën 11 në mëngjes, dhe më pas shkuam në Shkup. Dhe
25 më duket se pasditen e datës 11 kemi marrë instruktazhin e

1 parë nga COMKFOR-i. Ky ka qenë takimi i parë që kemi pasur me
2 SRSG-në, Sergio Vieira de Mello dhe COMKFOR edhe u ftova dhe
3 unë, Fabrizio -- Martin Griffiths, Fabrizio. U ftova dhe unë,
4 pra. Dhe në këtë takim diskutuam modalitetet e futjes sonë në
5 Kosovë të nesërmen.

6 Por ky ka qenë dhe instruktazhi disi më i thelluar që
7 kemi pasur në atë kohë. Gjithashtu, ne kishim dislokuar Martin
8 Griffiths dhe një anëtar tjetër të stafit tonë në Shkup,
9 kishte dy-tre javë që ishte vendosur në Shkup, paraprkisht
10 për të filluar me përgatitjet e raportimeve. Pra po përpigem
11 t'ju them që kishim edhe burime informacioni ne atje.

12 PY. Po informacionet të përpunuara të zbulimit, keni marrë?

13 PË. Nuk jam i sigurt të kem pasur ndonjë oficer informativ të
14 pranishëm atje, por nuk mund të them që kemi marrë instrukazhe
15 informative.

16 PY. Pra, ju e patë videon. A ju informuan juve çfarë të
17 prisnit atje se mund të kishte shumë emocione, njerëzit mund
18 të ishin shumë të tensionuar, mund të kishte rrezik se mund të
19 ndodhnin krime kundër serbëve, dhe çfarë duhet të bënit ju që
20 t'i parandalonit rastet e tilla, qoftë ju dhe KFOR-i.

21 PË. Nuk më kujtohet ndonjë instruktazh i tillë apo ndonjë
22 raportim i tillë. Ju thashë, ne kemi bërë diskutime, ky ka
23 qenë supozimi ynë, ky ka qenë dhe realiteti, që ne në fakt
24 pamë pas disa ditësh në terren.

25 PY. Pra, realiteti që kishte krime për shkak të hakmarrjes?

1 PË. Realiteti ishte që kishte shumë tension, edhe madje besoj
2 se ishte përmendur në një pjesë të deklaratës sime. Nuk më
3 kujtohet më cili paragraf. Pra, kemi pasur biseda me njëri-
4 tjetrin, dhe këto lindën për shkak të incidenteve që unë i
5 përmenda më herët. Për shembull, ky restoranti serb, rasti i
6 restorantit serb, që ishte djegur.

7 Kështu që, kur shkova atje Martin Griffiths, De Mello,
8 dhe thamë që ne nuk mund të qëndrojmë këtu si përfaqësuesit e
9 OKB-së dhe ta pranojmë këtë. Pra, kishim diskutime, sigurisht
10 u shprehën të njëjtat ndjenja edhe nga kolegët tanë, edhe nga
11 zëdhënësi i Departamentit të Shtetit.

12 PY. Pra me fjalë të tjera juve ju thanë që do të, duhet të
13 prisni që të ketë krime për shkak të hakmarrjes, dhe ju i patë
14 në të vërtetë krimet e tilla, po apo jo?

15 PË. Pjesa e dytë e fjalisë suaj, po. Pjesën e parë nuk më
16 kujtohet, nuk më kujtohet a na ka thënë njeri diçka të tillë.
17 Por ua thashë edhe më herët, shumë prej nesh kishin qëndruar
18 me vite të tëra në Ballkan, edhe të gjithë e supozonim këtë,
19 që do të ndodhte. Dhe siç tha dhe zëdhënësi nuk do të jetë një
20 kohë e lumtur për shumë persona.

21 PY. Në rregull.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim dhe njëherë deklaratën
23 tuaj, që mban numrin P1968, paragrafi 53, në PDF është faqja
24 14.

25 PY. Në këtë paragraf ju keni thënë që:

1 "Erdhën përfaqësuesit e UÇK-së dhe kishin një plan. Ata e
2 dinin çfarë donin dhe kjo ishte pushtet. E gjithë mendësia e
3 tyre në këtë luftë ishte të largonin serbët dhe të merrnin ata
4 në kontroll Kosovën."

5 Pyetja ime këtu është për termin "serb". Për kë e keni
6 fjalën ju, për të gjithë serbët këtu, për forcat serbe, për
7 kë?

8 PË. Për forcat serbe e kam pas fjalën.

9 PY. Mbi ç'fakte keni dalë ju në këto përfundime për
10 botëkuptimin apo mendësinë e tyre?

11 PË. Më lejoni të bëj një korrigjim, në fakt, e kisha fjalën
12 edhe për forcat serbe dhe për administratën serbe.

13 PY. Pra, ju keni dash të thoni që mendësia e UÇK-së apo ajo
14 që kërkonte UÇK-ja ishte të largonte forcat serbe dhe
15 administratën serbe, kështu duhet ta kuptojmë ne këtë?

16 PË. Parimisht, po. Por jo vetëm kaq. Sepse sipas nesh, ose të
17 paktën përshtypja jonë ishte që kishte elementë në UÇK, nuk po
18 përmend persona konkretë, por ka qenë një lloj mendësie apo
19 dhe ka pas diskutime kur ata thonin që ata duhet të largohen,
20 ata nuk janë, nuk i përkasin këtij vendi.

21 Pra, ka pasur një prani civile po ashtu, që konsiderohej
22 ndonjëherë mbase si shtrirje e okupatorit serb, forcave serbe
23 dhe qeverisë serbe, aparatit serb. E di që kur them serbë,
24 është njësoj si rasti me kosovarët, është e papërkufizuar, por
25 është shumë e vështirë ta themi me konkretësi këtë gjë. Pra,

1 ky nuk ka qenë thjesht diskutim teknik për largimin e
2 aparateve dhe të administratës serbe, apo të aparatit të
3 sigurimit. Por kishte përpjekje për ta shtrirë edhe më gjerë
4 tërheqjen e të, serbe. Kur them serbe, them edhe e kam fjalën
5 edhe popullatën serbe, apo me prejardhje serbe, pra kishte
6 persona që i donin larg, jashtë Kosovës.

7 PY. Shohim paragrafin tjetër në deklaratën tuaj. Këtu thoni
8 që UÇK-ja --

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Paragrafi 55, po lexoj paragrafin
11 55.

12 PY. Këtu thoni që UÇK-ja ishte kundër një Kosove multietnike
13 dhe kërkonte një Kosovë që i përkiste vetëm shqiptarëve të
14 Kosovës.

15 Në paragrafin 60, kalojmë më poshtë, këtu thoni:

16 "... ishte e mundshme edhe UÇK-ja kishte një qëndrim ..."

17 Është në faqen tjetër, nuk është në faqen aktuale. Pra:

18 "... UÇK-ja mori, ndërmori një qëndrim goxha më agresiv
19 për të marrë pushtetin në Kosovë dhe për ta kthyer Kosovën në
20 një vend që do të ishte vetëm për Kosovarët."

21 E shihni fjalinë e fundit këtu?

22 PË. Po.

23 PY. Ju e dinit besoj që z. Thaçi në mënyrë të vazhdueshme në
24 verën dhe vjeshtën e vitit 1999 ka kërkuar publikisht që të
25 ekzistonte një Kosovë multietnike.

1 PË. E pashë deklaratën në fakt më herët. Edhe e di që edhe ne
2 ia kemi kërkuar atij disa herë të bënte deklaratë të këtij
3 lloji.

4 PY. Shohim deklaratën 92 të deklaratës suaj, ju thoni që ju e
5 dini që ai ka bërë deklaratë të këtij lloji. Doni ta shihni në
6 ekran?

7 PË. Po, dua ta shoh në ekran.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në PDF, është tek faqja 23.
9 Paragrafi 92.

10 PY. Thuhet:

11 "Thaçi premtoi disa herë që të bënte të pamundurën për të
12 përmirësuar situatën e sigurisë dhe ka bërë dhe ka deklaratë
13 publike për pajtim, dhe bashkekzistencë paqësore mes
14 shqiptarëve të Kosovë dhe serbëve të Kosovës."

15 Pra, ju e keni pranuar që e dinit që z. Thaçi ka bërë
16 deklaratë të tilla publikisht për një Kosovë multietnike.

17 PË. Po, jam në dijeni që kanë ndodhur deklaratë të tilla dhe
18 ne ia kemi kërkuar ndonjëherë atij ta bënte këtë gjë. Nuk
19 kisha dijeni për atë që më treguat ju, konkretisht, por në
20 përgjithësi po. Sidoqoftë, jua shpjegova më herët, një gjë
21 është ajo që i kemi kërkuar ne dhe që ishte e nevojshme në ato
22 rrethana, të paktën sipas nesh, përshtypja jonë ishte që të
23 zbuteshin pak edhe tensionet politike që po krijoheshin në atë
24 drejtim. Dhe tjetër ishte më pas realiteti në terren.

25 PY. Flasim më vonë se si keni dalë ju në këto përfundime, por

1 e marrim sipas radhës.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Fillojmë me materialin që mban
3 numrin DHT0439 [Sipas përkthimit]. Është dokumenti i Kombeve
4 të Bashkuara që ju tregova më herët. Pra, ju lutem, edhe një
5 herë të vendosim në ekran materialin dht04942.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Cilin dokument doni,
7 deklaratën në ekran? E doni deklaratën në ekran?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ju lutem. Vendoseni përbri.

9 Edhe një herë, faqja konkrete që nevojitet të shfaqet në
10 ekran është faqja DHT04942.

11 PY. Është dita 14, 24 qershor, dhe këtu thuhet:

12 "Në takimin e tyre publik në selinë e Misionit të Kombeve
13 të Bashkuara në Kosovë, arqipeshkvi serb Artemije dhe
14 udhëheqësi i UÇK-së Thaçi i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe
15 shkëmbyen disa fjalë."

16 Keni dijeni për këtë ngjarje?

17 PË. Besoj se po, më kujtohet vagullt takimi, por nuk kam
18 hollësi.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj
20 pranimin e kësaj faqeje, do të lutesha që t'i bashkëngjitej
21 dokumentit me numër 1D228.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
23 kundërshtime? Okej, në rregull. Dokumenti me numër DHT04942
24 pranohet.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do t'i

1 bashkëngjitet provës me numër 1d00228. Faleminderit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Dy ditë pas kësaj ngjarjeje, a ju kujtohet që ka qenë një
4 situatë e tensionuar mes civilëve shqiptarë dhe serbë në
5 Mitrovicë, pas luftës? Ju kujtohet kjo ngjarje?

6 PË. E keni fjalë për rastin mbi urë?

7 PY. Po.

8 PË. Dhe mund të kem qenë më duket atje.

9 PY. Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran materialin

11 DHT04926, DHT04927, dhe ky është një dokument që nuk duhet të
12 shfaqet për publikun.

13 PY. Është një kabllogram i koduar, është e 26 qershorit 1999,
14 ka një ballinë këtu, dhe ka një shënim që z. De Mello ka
15 dërguar në Nju-Jork për vizitën që ka bërë ai vetë në
16 Mitrovicë atë paradite. Dhe thotë:

17 "UÇK-ja duket se ka nxitur demonstratat që kanë krijuar
18 një situatë të acaruar dhe të përgjakur. Ftoj z. Thaçi --
19 ftova z. Thaçi", më falni, "të shkonte sot paradite në
20 Mitrovicë në mënyrë që t'u thoshte udhëheqësve lokalë të UÇK-
21 së dhe turmave shqiptare që të tërhiqeshin nga plani i tyre."

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen e radhës.

23 PY. Në paragrafin e parë këtu thuhet:

24 "Gjatë një takimi që z. Thaçi më 25 qershor SRSG-ja
25 ngriti problematikën e situatës së acaruar në Mitrovicë,

1 veçanërisht sa i takon spitalit, e cila është në pjesën serbe
2 të qytetit që donin ta merrnin me forcë shqiptarët. SRSG-ja i
3 kërkoi z. Thaçi të përdorte ndikimin që kishte ai për t'i
4 qetësuar shqiptarët e Kosovës në Mitrovicë. Thaçi menjëherë,
5 pa hezitim, pranoi ta bënte këtë. SRSG-ja dhe Thaçi më pas u
6 pajtuan të shkonin atje së bashku. DCOMKFOR, Gjenerali Thomann
7 e mirëpriti nismën dhe ofroi madje një helikopter për
8 paraditen e 26 qershorit."

9 Në paragrafin e radhës ka disa hollësi për vizitën që
10 është bërë tek spitali. Thotë që:

11 "Thaçi, në praninë e SRSG-së iu drejtua doktorëve serbë
12 dhe shqiptarë, tha që mbështeste marrëveshjen, e theksoi
13 nevojën për një zgjidhje paqësore për problemet ekzistuese në
14 Kosovë. Vizita e tij u vlerësua mirë, pozitivisht."

15 Më pas thotë, në paragrafin e radhës:

16 "Pas një diskutimi të shkurtër u ra dakord që Thaçi t'i
17 drejtohej turmave, t'i qetësonte personat. Në fjalimin e tij
18 ai kërkoi të kishte qetësi, theksoi suksesin për negociatat që
19 kishin pasur për spitalin, theksoi rolin pozitiv të KFOR-it
20 dhe kërkoi për durim ndërkohë që situata do të përmirësohej.
21 Fjalimi i tij pati efektin e dëshirueshëm, personat u
22 qetësuan, dhe filluan të shpërndareshin dhe, filluan të
23 shpërndareshin pasi u largua SRSG-ja. Përpara largimit, u bë
24 një takim i shkurtër me COMKFOR-in të cilët po ashtu kishin
25 mbërritur në Mitrovicë për një vizitë të shkurtër, dhe e

1 falënderuan Thaçin për ndërhyrjen e tij.

2 "Koment: Vizita e përbashkët me Thaçin drejt bazës së
3 KFOR-it me helikopter të KFOR-it është një gjë e pazakontë,
4 por në situata të pazakonta, në rrethana të pazakonta, ajo
5 ishte e nevojshme për një nismë të tillë."

6 Keni qenë ju i pranishëm kur ka ndodhur kjo?

7 PË. Më kujtohet që kam qenë në një udhëtim në Mitrovicë kur
8 ka ndodhur situata mbi urë. Por nuk më kujtohet a është vizita
9 ime e parë apo e dytë, por më duket se kam qenë pjesë e kësaj
10 vizite.

11 PY. Po, a e pranoni ju siç thuhet këtu që z. Thaçi sapo iu
12 kërkua, pa hezitim pranoi të shkonte ta qetësonte situatën?

13 PË. Po besoj se ky ishte synimi kryesor, ky ishte synimi i
14 një misioni të përbashkët, që të qetësohej situata
15 konfliktuale.

16 PY. A e pranoni që ky është një shembull se si z. Thaçi ka
17 promovuar një zgjidhje paqësore dhe nuk ka kërkuar asnjëherë
18 të ketë situata kaotike?

19 PË. Ua thashë edhe më herët, z. Thaçi dhe në raste të tjera
20 ka bërë thirrje të tilla dhe është shembull sigurisht se si ai
21 ka luajtur një rol shumë të dobishëm, shumë të frytshëm për
22 zgjidhjen e situatave të këtilla, të paktën në planin
23 afatshkurtër.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet dokumenti si
25 pjesë e provave gjyqësore dhe gjykoj dhe mendoj që duhet të

1 jetë dokument konfidencial.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
3 kundërshtime?

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
6 DHT04926, 04927 pranohet.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
8 numrin e provës 1d229, me klasifikim konfidencial.
9 Faleminderit.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

11 Për kohën që na ka mbetur, dhe pesë minutat përpara
12 pushimit, do të doja t'ju tregoja dokumentin SITF40000767 deri
13 në 40000769. Faleminderit.

14 Ndërkohë dokumentet që janë në ekran mund të hiqen.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkesa ime është që dokumenti të
16 mos jetë publik, dhe madje pjesa që do lexohen me zë të
17 redaktohen për publikun.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, a mund të
19 kalojmë për një çast në seancë private, atëherë?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
21 seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 104

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 106

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 107

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 108

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 Faleminderit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, një përditësim do t'ju jepja.
2 Gjërat kanë ecur më ngadalë se ç'kisha shpresuar për shkak të
3 numrit të dokumenteve dhe përgjigjeve të gjata të dëshmitarit,
4 unë do të përpiqem që të përshpejtoj pyetjet e mia, por besoj
5 se do të më duhet e gjithë dita e sotme.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Nëse ju ndihmon, ne kemi reduktuar
7 në fakt kohën tonë, siç ua komunikua edhe me postë
8 elektronike më herët. Besojmë që do të na nevojitet vetëm
9 gjysmë ore.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po të tjerët,
11 ka ndonjë ndryshim të kohës? Jo me sa shoh.

12 Në rregull, atëherë. Në rregull. Rikthehem në orën 14.30

13 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

14 --- Seanca rifillon në orën 14.30

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Sekretare, ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, sepse shtypa butonin e
20 gabuar.

21 Do të vazhdojmë me dëshminë tuaj, z. Strohmeyer. Ju
22 lutemi, dëgjojeni me vëmendje Mbrojtjen e z. Thaçi.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

24 PY. Mirëdita, përsëri, z. Strohmeyer.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar i seancës, do ju

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 110

1 kërkoja që shkurtimisht të kalojmë në seancë private. Në fakt,
2 duhet t'ju isha drejtuar juve, z. Gjykatës, jo Sekretarit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 jemi në seancë të hapur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Mund të vazhdoni, z. Misetic.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, le të kalojnë tek një
2 dokument. Do ju kërkoja që të transmetohet një video që ka
3 numër identifikimi DHT00973 dhe transkriptin shoqërues që
4 është DHT00973-TR-ET.

5 PY. Për t'jua sqaruar ndërkohë që shfaqet dokumenti, z.
6 Strohmeyer, kjo është një video e një konference për shtyp që
7 është organizuar nën drejtimin e z. De Mello më 2 korrik 1999,
8 ku ishin të pranishëm përfaqësues të ndryshëm të komuniteteve
9 në Kosovë të cilët kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët ku
10 bënin thirrje për një Kosovë multietnike dhe fundin e dhunës,
11 duke iu bërë thirrje personave që ishin larguar që të
12 ktheheshin dhe duke iu bërë thirrje gjithashtu edhe pakicave
13 të tjera serbe dhe pakicave të tjera që të qëndronin në
14 Kosovë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë do i kërkoja Sekretarit që
16 të ndalojë videon në sekondën e 58, në mënyrë të tillë që t'i
17 jepen mundësia përkthyesve që të përkthejnë, të bëhen gati që
18 të përkthejnë për procesverbal nga anglisht - nga shqipja në
19 anglisht.

20 Domethënë, do ju kërkoj edhe një herë që të bënit një
21 pauzë në sekondën e 58.

22 [Luhet videoincizimi]

23 "Sot besoj - ju bëj thirrje të gjithë udhëheqësve
24 shqiptarë që të takohen dhe që të flasin për një dialog që
25 kanë të bëjnë me sigurinë, të drejtën për jetë, për të qenë

1 ambient i qetë dhe të drejtën për pronë të të gjithë banorëve
2 të kësaj krahine.

3 "Ju lumtë."

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë edhe një herë për
5 përkthyesit. Do ju kërkoja që tani të përktheni, por përpara
6 se të transmetohet përsëri video, z. Strohmeier, a mund të na
7 thoni, a ju kujtohet, a keni qenë i pranishëm në këtë
8 konferencë për shtyp, apo jo?

9 PË. Nuk më kujtohet a kam qenë a nuk kam qenë. Më kujtohet që
10 është organizuar një ngjarje e tillë, por nuk di t'ju them më
11 tepër; nuk e kujtoj në qoftë se kam qenë i pranishëm apo jo.

12 PY. Në rregull.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem,
14 transmetojeni videon deri në minutën e parë, në sekondën e 16.

15 [Luhet videoincizimi]

16 "Lusim të gjithë qytetarët e Kosovës, qofshin ata me
17 status civil apo ushtarakë, të përmbahen dhe të ndikojnë te të
18 tjerët që të mos ndërmarrin akte dhune ndaj fqinjëve të tyre.
19 Miq, veprime të tilla janë të papranueshme. Përgjegjësit e
20 veprimeve të tilla do të sillen para drejtësisë."

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Tani, z. Strohmeier, z. Thaçi lexoi pjesë të një
23 deklarate të përbashkët në publik të një konferencë për shtyp.
24 A është e vërtetë kjo, z. Strohmeier?

25 PË. Po.

1 PY. Kjo është një thirrje publike nga z. Thaçi dhe nga
2 nënshkruesit e tjerë për persona të cilët ishin të angazhuar
3 në dhunë që të ndalonin angazhimin e tyre në dhunë, apo jo?

4 PË. Po.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që videoja
6 dhe transkripti të pranohen në prova gjyqësore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
11 DHT00973 dhe transkripti që është DHT00973-TR-ET pranohen në
12 prova gjyqësore.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
14 Gjykatës. Do t'i caktohet numri i provës gjyqësore 1D00231 dhe
15 klasifikimi është publik.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar. Do
17 kërkoja që tani të paraqitet në ekran dokumenti DHT01302 deri
18 në DHT01304.

19 PY. Z. Strohmeier, a jeni në dijeni që Sergio Vieira de Mello
20 ka botuar një artikull në faqet e gazetës *New York Times* në
21 vitin 1999? Në gusht të '99-s, më saktë.

22 PË. Tani që po e shikoj më kujtohet diçka. Megjithatë, në
23 qoftë se nuk do e kisha parë këtë pjesë, nuk do më ishte
24 kujtuar asgjë.

25 PY. Në rregull.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të kalojmë te faqja DHT01303.

2 Atëherë të kalojmë te pjesa që fillon "Hapi i parë". Atëherë

3 ky është një artikull ku z. De Mello bën thirrje që të mos

4 bëhet aparteid në Ballkan, domethënë ndarje etnike.

5 PY. Dhe në paragrafin që keni këtu përpara thuhet:

6 "Hapi i parë është i pajtimit është që të njihet, të

7 pranohen padrejtësitë dhe thuhet gjithashtu që drejtuesit

8 lokalë serbë kanë ardhur për të diskutuar së bashku me

9 homologët e tyre shqiptarë që të diskutojnë masa konkrete për

10 përmirësimin e sigurisë dhe për afirmimin e rëndësisë jetike

11 të mbajtjes së Kosovës si një vend multi-etnik."

12 Ndërkohë që vazhdohet me fjalinë tjetër, në faqen tjetër

13 që thuhet:

14 "Udhëheqësit shqiptarë kanë dënuar fort dhunën dhe

15 persekutimin kundër banorëve serbë në Kosovë."

16 Sikurse e dëgjuam sot, një prej udhëheqësve shqiptarë që

17 z. De Mello nënkupton me këtë gjë është z. Thaçi, apo jo? A

18 është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po më pyet në qoftë se është e saktë apo jo?

20 PY. Po.

21 PË. Po, është e saktë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të pranohet

23 në provë gjyqësore.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni ndonjë

25 kundërshtim?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 115

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
3 DHT0132 deri në DHT0134 [Sipas përkthimit] pranohen në prova
4 gjyqësore.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
6 të marrë numrin e provës 1D00232. A mund të më thoni çfarë
7 klasifikimi ka dokumenti?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokument publik.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Do të
10 klasifikohet si publik dokumenti.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Z. Strohmeier, dua t'ju tregoj një deklaratë që ka bërë
13 Gjenerali Jackson që e ka bërë përpara Gjykatës së Lartë në
14 Angli. Për procesverbal është dokumenti 121843 [Sipas
15 përkthimit] deri në 121658. Në fakt është dëshmia që ka dhënë
16 në një proces gjyqësor përpara një gjykate angleze.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Përkthimi në shqip është
18 i ndarë në dy pjesë. Nuk e di, a është e nevojshme që të
19 tregojmë përkthimin në shqip apo jo?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk është e nevojshme që të
21 tregoni dokumentin në shqip.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 121185 [Sipas
24 përkthimit] - ja të gjej pak rreshtin - duke filluar nga
25 rreshti 5.

1 PY. Pra, ky është Gjenerali Jackson që flet. Ai thotë:

2 "Po, unë nuk kam pas prova vetë që mendoj që ju po
3 nënkuptoni këtë dhe ju kërkoj ndjesë në qoftë se nuk është
4 kështu rasti që UÇK-ja në aspektin institucional, domethënë,
5 sipas politikave të tyre, nuk është se kanë kryer akte
6 terroriste kundër askujt. Nuk po them që individë të caktuar
7 të mos e kenë bërë këtë gjë, por nuk kam prova që tregojnë që
8 këtë gjë e ka bërë UÇK-ja apo ka qenë politikë e UÇK-së."

9 Dhe më poshtë thuhet - ju kërkoj ndjesë se bëra citimin e
10 gabuar.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt nga një faqe tjetër.
12 Atëherë do i kërkoja Sekretarit që të kalojë te faqja tjetër.
13 Është faqja 121595.

14 PY. Është temë e cila del përsëri dhe duke filluar nga
15 rreshti 23, ai thotë:

16 "Dua që të përqendrohem tek UÇK-ja, dhe këtu po
17 përqendrohem te konstatimet e Senator Martit?"

18 Gjenerali Jackson thotë:

19 "Ju po filloni që të implikoni që ka qenë politikë e UÇK-
20 së, dhe unë nuk mund të them që pajtohem me ju lidhur me këtë.

21 "PY. Unë nuk po sugjeroj që ka qenë politikë e UÇK-së që
22 të spastrohet çdo serb i vetëm, por thjesht po marr dëshmi
23 tuaja dhe prej aty po vazhdoj më tej me shtjellime. Por nuk ka
24 pikë dyshimi në kohë në qoftë se ka pasur politikë apo jo dhe
25 deri në çfarë pike lart në hierarki ka shkuar një politikë e

1 tillë. Unë po mbështetem në atë çfarë ka konstatuar Senator
2 Marty pas dy vjet e gjysmë në lidhje me UÇK-në. A ka qenë ky
3 qëndrimi që keni pasur në lidhje me UÇK-në kur keni qenë në
4 Prishtinë dhe kur jeni takuar me ta?"

5 Gjenerali Jackson thotë:

6 "Sigurisht."

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit të
8 kalojmë në një faqe tjetër që më konkretisht është 12194
9 [Sipas përkthimit].

10 PY. Tek rreshti 5, duke filluar nga rreshti 5:

11 "Për aq sa objektivat tuaj ishin që të parandaloheshin
12 krimet e mëtejshme humanitare ose vrasja i takon që grupi
13 kryesor që donin të mbronin kanë qenë serbët, apo jo?

14 "PË. Po. Dhe ne kemi bërë shumë punë lidhur me këtë.

15 "PY. E keni cekur këtë element, por sa i takon UÇK-së që
16 ka përmbajtur elementë të tërhequr ose që ishin neutral lidhur
17 me të ka pasur synim ose probleme të tjera ose katastrofa të
18 tjera të kësaj natyre dhe a keni qenë ju të informuar sa i
19 takon këtij rreziku?

20 "PË: Po

21 "PY: A keni parë juve dhe a keni bërë atë çfarë nevojitej
22 që të bëhej për të parandaluar UÇK-në pjesërisht, në qoftë se
23 jo plotësisht që të silleshin në këtë mënyrë?"

24 Përgjigja që jep Gjenerali Jackson është:

25 "PË. Në fakt është pyetje e përbërë; kërkon shumë

1 informacion lidhur me këtë.

2 "PY. Më vjen keq, por po ju pyes dhe një herë tjetër: A
3 mendoni se mund të ketë qenë kjo situata?"

4 "PË. Unë them që nuk kam dëshmi, nuk kam prova që
5 institucionalisht UÇK-ja ka pasur një politikë të pastrimit
6 etnik për serbët e tjerë të mbetur në Kosovë."

7 Tani, a keni ndonjë arsye për të mos rënë dakord juve me
8 këtë çfarë ka thënë Gjenerali Jackson, Dëshmitar?

9 PË. Jo.

10 PY. Po ai brenda KFOR-it ka qenë një ndër komandantët
11 kryesorë, domethënë, në zinxhirin e komandës në KFOR ka qenë
12 një ndër personat kryesorë, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, duket në disa raste, pra, në disa pjesë të dëshmisë
15 së tij, ju lexova përfundimin e Gjeneralit Jackson. Ai ka
16 arritur në këtë përfundim; ju keni ndonjë arsye për të mos e
17 pranuar këtë përfundim të tij?

18 PË. Jo, kështu, ky duket që është përfundimi i tij, po.

19 PY. Do kalojmë në një dokument tjetër.

20 PË. Më lejoni të bëj një koment se mendoj se është i
21 rëndësishëm. Gjenerali Jackson i bëhet pyetja, në qoftë se ka
22 qenë politikë e përgjithshme e UÇK-së për spastrimin e të
23 gjithë serbëve dhe këtu më tepër futet te pjesa e politikës së
24 spastrimit etnik që të paktën është term ligjor që ka një
25 konotacion konkret.

1 Megjithatë, më lejoni ta bëj shumë të qartë. Në të gjithë
2 deklaratën time unë nuk besoj që flas për një politikë të
3 përgjithshme, sepse politika në vetvete është një vendim shumë
4 i synuar ose i qëllimshëm që shkon në një drejtim të caktuar.

5 Megjithatë, ka, mund të ketë, domethënë, sjellje që bën
6 të mundur ose i lejon akteve të caktuara që të shkojnë për
7 përbushjen e një politike të caktuar. Domethënë, ajo çfarë po
8 përpiqem të them është që mund të ketë një dallim midis asaj
9 çfarë deklaroi Gjenerali Jackson këtu nga konstatimi që ka
10 pasur ai nga konstatimet dhe përshtypjet që më janë krijuar
11 mua gjatë kohës kur kam qenë atje. Çfarë dua të them me këtë
12 është që edhe nën nivelin e politikave të deklaruara ka pasur
13 veprime të shpërndara kundër serbëve ose dhunë ndaj serbëve.
14 Kjo ka qenë përshtypja jonë edhe sipas përshtypjes tonë kjo as
15 nuk është parandaluar, pavarësisht deklaratave publike dhe në
16 disa raste as nuk është çmundësuar ose e bërë e pamundur një
17 politikë e tillë. Atëherë sa i takon aspektit ligjor pa
18 diskutim që nuk është vendim tek i cili unë kam arritur; nuk
19 është qëndrimi im që ka pas një politikë të tillë e të
20 përgjithshme.

21 PY. Në rregull. Të shikojmë një dokument tjetër.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti është 076680 deri në
23 076888 [Sipas përkthimit].

24 PY. Ky është një raport i të drejtave të njeriut që është
25 lëshuar prej OSBE-së. Është një dokument i cili titullohet

1 "Siç është parë ashtu është treguar", Volumi II. A e keni
2 dëgjuar ndonjëherë një botim të tillë? E di çfarë përmban ai,
3 dëshmitar?

4 PË. Mund ta kem ditur atëherë, por tani për momentin nuk më
5 kujtohet. Megjithatë, mendoj që do kemi qenë të interesuar,
6 domethënë, të informuar lidhur me këtë dokument. Megjithëse
7 nuk besoj që kemi qenë të përfshirë në prodhimin e këtij
8 raporti.

9 PY. Atëherë. Siç mund ta shikoni në fillim fare me shkrimin e
10 dorës janë fjalë të cilat janë shkruar nga z. Bernard
11 Kouchner. Tani do t'ju tregoj vlerësimin e tij që është dhënë
12 në nëntor të vitit 1999.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye do i
14 lutesha Sekretarit të kalojmë në faqen 076685.

15 PY. Është ky paragrafi që është i theksuar me ngjyrë gri të
16 errët. Në të shkruhet, në nëntor të vitit 1999 [Sipas
17 përkthimit]:

18 "Ne ishim shumë të shqetësuar për situatën e pakicave. Në
19 qoftë se do i hidhnim një sy të shpejtë të tendencës do të
20 dukeshin politika të caktuara. Kishte një ulje të numrin të
21 vrasjeve nga java e përparshme dhe sigurisht, domethënë, edhe
22 një krim i vetëm është shumë. Megjithatë, gjërat po
23 ndryshojnë. Nuk është e drejtë që të bëhen krahasime me
24 situatën përpara ose gjatë luftës. Në atë kohë, për të paktën
25 një dekadë, ka pasur një politikë të vazhdueshme aparteidi,

1 një status nën-njerëzor ose të paktën një status nën-
2 komuniteti për shqiptarët në Kosovë. Nuk është më rasti ky
3 sot. Ndoshta duket po ashtu keq për serbët dhe romët të cilët
4 jetojnë në frikë, nuk mund të lëvizin lirshëm ose të gjejnë
5 mënyra për të mbrojtur fëmijët e tyre, por nuk është më
6 çështje e politikës. Të gjitha palët në Kosovë, të gjithë
7 udhëheqësit serbë dhe shqiptarë, kanë shprehur qëndrimin e
8 tyre se janë në favor të një shoqërie shumë-etnike dhe
9 bashkëjetesës midis të gjitha komuniteteve. Krimet të cilat i
10 shohim janë veprime të individëve. Asnjë parti politike nuk ka
11 pretenduar përgjegjësi për to. Përfaqësuesit e tyre në
12 Këshillin Kalimtar të Kosovës kanë dënuar këto abuzime çdo
13 herë dhe ata vetë kanë shprehur shqetësimin e tyre rreth
14 këtyre veprave të mungesës së tolerancës, nuk mund të
15 përjashtojë mundësinë e fjalëve me dy kuptime, por as nuk mund
16 ta supozojmë atë.”

17 A e pranoni përfundimin e Përfaqësuesit të Posaçëm të
18 Sekretarit të Përgjithshëm që situata pas 10 qershorit në
19 vitin 1999 ka qenë ndryshe në Kosovë dhe që nuk ka pasur
20 politikë për të synuar serbët dhe pakicat rome?

21 PË. Sqarimi i parë është që ky është një raport i nëntorit
22 '99, apo jo?

23 PY. Po.

24 PY. Dëshiroj që të dalloj dy gjëra këtu: Kjo ka ndodhur pasi
25 unë kam qenë në Kosovë. Atëherë, së pari, në paragrafin e

1 parë, pjesa e parë është e saktë dhe këtu tregohet dhe e
2 njëjta gjë që dëshiroj që t'jua bëja edhe unë me dije dhe që
3 jua bëra pak më herët, në fakt, se ka një dallim midis
4 politikës ose politikës së përgjithshme dhe ai bën krahasimin
5 e regjimit në veçanti pas '89-s në Kosovë dhe çfarë ai e
6 përshkruan si aparteid dhe përjashtimit të vazhdueshëm për
7 çështje ligjore, çështje të qasjes së pozicionit të caktuar e
8 kështu me radhë. Dhe me këtë pjesën jemi të gjithë dakord,
9 pajtohemi me këtë pikë. Në këtë kuptim ai thotë që nuk ka
10 pasur një politikë të tillë të përgjithshme të shprehur nga
11 askënd dhe unë pajtohem me të lidhur me këtë. Dhe ka pasur një
12 deklaratë shumë të qartë që është thënë qartazi që nuk do kemi
13 një shtet ku Serbia nuk do jetë e përfaqësuar, por realiteti
14 ishte i tillë edhe mbase mund ta diskutojmë këtë më vonë.
15 Megjithatë, realiteti ka qenë që ka pas presion në këtë
16 drejtim. Ajo çfarë po përpigem të them është që ka dallim
17 midis politikës së përgjithshme dhe disa prej realiteteve që i
18 kemi prekur me dorë ne.

19 Sa i takon përfundimit të Përfaqësuesve të Posaçëm të
20 Sekretarit të Përgjithshëm, edhe kjo është pjesa e dytë e
21 komentit tim, këto mund të jenë akte të individëve që mund të
22 kenë qenë përfundimin e tij në nëntor të '99. Megjithatë, jo
23 domosdoshmërisht këto mund të jenë përfundimet e mia gjatë
24 periudhës që unë kam qenë në Kosovë. Dhe përsëri mendoj që ai
25 bën një cilësim të mëtëjshëm drejt fundit të paragrafit lidhur

1 me këto situata dhe thotë:

2 "Nuk mund ta përjashtojmë mundësinë e fjalëve me dy
3 kuptime, por as nuk mund ta supozojmë atë."

4 Nuk më duket sikur ky paragraf që keni nënvizuar është i
5 qartë në kuptimin e politikës së UNMIK-ut në atë kohë. Pra,
6 kur thotë Kouchner që nuk ka pasur dhunë të organizuar kundër
7 serbëve, ajo çfarë po thotë ai nuk është çështje politike të
8 përgjithshme, por në veçanti nuk është çështje politike të
9 përgjithshme që ka ndjekur Serbia në të gjithë Kosovën, kur
10 Kosova ka qenë nën kontrollin e Serbisë përpara 10 qershorit.

11 Ky është komenti im; ky është interpretimi im i këtij
12 paragrafi.

13 PY. Pra, ju nuk pajtohem me deklaratën e tij që këto kanë
14 qenë krime të individëve ose të kryera nga persona të caktuar?
15 Dëshiroj që juve të na thoni se cila është baza faktike e
16 mospajtimit tuaj me të.

17 PË. Nuk thashë që nuk pajtohem me të, por ky është përfundimi
18 im; përfundimi im është i ndryshëm nga përfundimi i tij.

19 PY. Ndalo këtu një çast. A pajtoheni apo jo me qëndrimin që
20 këto janë krime të individëve?

21 PË. Ajo çfarë po them unë është që gjatë kohës ku ka qenë aty

22 --

23 PY. Ju lutem, përgjigjuni pyetjes.

24 PË. Kjo është deklarata e tij, nuk kam pse të bie dakord ose
25 jo unë me të.

1 PY. Po mirë, në rregull. Do jua bëj ndryshe pyetjen. Në
2 Kosovë krimet që janë kryer, a kanë qenë akte individësh ose
3 persona të caktuar?

4 PË. Çdo akt është akt individ i ose personi të caktuar, por
5 kjo nuk do të thotë që nuk ka një mjedis të organizuar
6 mundësues ose me fjalë të tjera, nuk do të thotë që ka
7 përpjekje më koherente pas këtij qëndrimi. Vendoseni pak veten
8 në një situatë kur kemi qenë ne; vendoseni veten në vendin
9 tonë.

10 PY. Ju lutem. Unë po ju kërkoj fakte, nuk po ju kërkoj
11 supozime. Më thoni faktet të cilat ju e mbështetni
12 supozimin tuaj që bëhej fjalë për një mjedis të organizuar dhe
13 koherent.

14 PË. Për këtë -- këtu dua të dal. Ishte një grup që
15 pretendonte ose e prezantonte veten dhe në fakt sipas mendimit
16 tim kështu ishte që ky grup e kishte kompetencën ose fuqinë
17 për të qenë i organizuar. Për shembull, Agim Çeku në një prej
18 takimeve e ka thënë këtë shprehimisht, e ka thënë që e kishte
19 strukturën për të organizuar. Pra, bëhej fjalë për persona që
20 ishin me armë, pra, kishin armë dhe në qoftë se do të shohim
21 disa prej raporteve të cilat ne i pamë edhe më herët, i
